



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government



Komuna e Gllogocit
Drejtoria për Shërbime
Publike dhe Emergjencë

PLANI I REAGIMIT EMERGJENTË (PRE) PËR KOMUNËN E GLLOGOCIT

PLANI BAZIK

Tetor, 2025

TABELA E PËRMBAJTJES

Ballina.....	1
Përmbajtja.....	2
Hyrje	7
SHTRIRJA.....	8
FME-të:	22
VI. Zhvillimi dhe Mirëmbajtja e Planit	44
Kryqi i Kuq i Kosovës.....	49
Spektori i Komandës.....	49
Post Komanda	49
Menaxhimi Gjithpërfshirës i Resurseve	49
Koordinimi	50
Emergjencia.....	50
Dekontaminimi.....	50
Emergjencë/Fatkeqësi/Incident	50
Sistemi i Alarmimit Emergjent.....	50
Qendra e Operative Emergjente Lokale.....	50
Plani i Reagimit Emergjent	51
Menaxhimi Emergjent.....	51
Funksioni i Mbështetjes Emergjente.....	51
Ushtrim.....	51
Evakuimi	51
Sistemi Informativ Gjeografik.....	51
Materiet e Rrezikshme	51
Komandanti i Incidentit.....	52
Raporti i Vlerësimit të Dëmeve Fillestsare	52
Plani i Komunikimit të Integruar	52
Emergjencë Lokale	52
Lehtësimi/Zbutja	52
Marrveshje për Ndihmë Reciproke	53

Shërbimi Meteorologjik Kombëtar.....	53
Gatishmëria	53
Shpallja Presidenciale.....	53
Agjencia Parësore.....	53
Qendra Rajonale për Koordinimin e Informacioneve	53
Raport Situate	54
Harku i Kontrollit	54
Gjendja Emergjente.....	54
Komanda e Bashkuar.....	54

LISTA E PLOTË FUNKSIONALE

DORACAKU I NJOFTIMEVE DHE BURIMEVE (DNB)

Publikuar veq e veq

SHPALLJA-DEKRETIMI**Dokumenti Dekretues**

Dokumenti dekretues e venë “në fuqi” PREL (Planin e Reagimit Emergjent Lokal). E shpall zyrtarisht planin dhe e bënë zyrtar duke i dhënë autoritetin dhe përgjegjësinë organizatave të përcaktuara në të për kryerjen e detyrave për identifikimin, përgatitjen dhe mirëmbajtjen e procedurave standarde operative të cilat shpjegojnë se “si” do të përmbushen detyrat e caktuara. Gjithashtu i bënë këto organizata të trajnohen dhe ushtrojnë sipas nevojave për implementimin e planit.

Dekretimi i Planit të Reagimit Emergjentë

Me autoritetin tim të dhënë dhe në bazë Ligjit mbi Vetëqeverisjen dhe nenin 91, pika 1.2 TË LIGJIT NR. 04/L-027 PËR MBROJTJE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA, miraton dhe **dekretion**, si **kryetar i Komunës së Gllogocit** dhe si administrator me autoritetin përfundimtar për menaxhimin emergjent në **Komunë**, Unë shpall dhe aktivizoj Planin e Reagimit Emergjent (“Planin 001”) të **Komunës**.

PRE për **Komunën** ofron reagimin ndaj emergjencave dhe Fatkeqësive Natyrore dhe Fatkeqësive tjera me qëllim të: **Shpëtimit të jetëve, mbrojtjes së shëndetit publik, sigurisë dhe të mirave materiale, restaurimin e shërbimeve esenciale dhe për të mundësuar dhe asistuar në rimëkëmbjen ekonomike.**

Në bazë të nenit **46, pika 2** të LIGJIT NR. 04/L-027 PËR MBROJTJE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA, **PRE** është në pajtim me Sistemin e Integruar të Menaxhimit të Emergjencave në Republikën e Kosovë, Planin e Vlerësimit të Rrezikut për Komunën e Gllogocit dhe në harmoni me Planin e Reagimit Kombëtar.

Koordinatori i Menaxhimit Emergjent i Komunës, në bazë të nenit 47, pika 4 të Ligjit NR. 04/L-027 PËR MBROJTJE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA, në emër të kryetarit të Komunës është i autorizuar të aktivizoj **Qendrën Operative Emergjente Lokale (QOEL)** të Komunës me qëllim të drejtimit

dhe kontrollit të operacioneve emergjente të **Komunës**. Plotësimi i QOEL do ta strukturoj implementimin e planit.

Për më tepër, **Koordinatori i Menaxhimit Emergjent i Komunës** gjithashtu është i autorizuar që në koordinim me **Kryetarin e Komunës, në bazë të nenit 47** të LIGJIT NR. 04/L-027 PËR MBROJTJE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA ,ta plotësoj/amandamentoj Planin, sipas nevojës për ofrimin dhe krijimin e sigurisë dhe shëndetit të vazhdueshëm të banorëve dhe të mirave materiale të **Komunës**.

Sipas Planit, drejtori i secilës drejtori, sektor të **Komunës** do të caktoj nga një udhëheqës dhe së paku nga një zëvendës për drejtorinë, sektorin përkatës. Ky Dekret hynë në fuqi me nënshkrimin e tij dhe mbetet në fuqi të plotë derisa të amandamentohet apo shfuqizohet nga dekretet tjera.

Kryetari i Komunës së Glllogocit: Dita: _____ / Data: _____, Muaji: _____ ,Vit: _____

APROVIMI DHE IMPLEMENTIMI

VENDIM

PLANI I REAGIMIT EMERGJENT

DUKE PAS PARASYSH QË: Kryetari i Komunës së Glogocit dhe Asambleja Komunale njohin nevojën për tu përgatitur, reaguar dhe rimëkëmbur nga Fatkeqësitë Natyrore dhe fatkeqësit Tjera dhe ato të shkaktuara nga faktori njeri; dhe

DUKE PAS PARASYSH QË: Kryetari i Komunës ka përgjegjësi ligjore për siguri dhe mirëqenje të qytetarëve dhe vizitorëve të tij; dhe

DUKE PAS PARASYSH QË: **Kryetari** ka vendosur dhe caktuar Drejtor dhe Koordinator të Menaxhimit Emergjent; kështu që:

Pas shqyrtimit të Planit të Reagimit Emergjent, Kryetari i Komunës së Glogocit dhe Asambleja Komunale, në bazë të nenit **46, pika 2 të** LIGJIT NR. 04/L-027 PËR MBROJTJE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA, VENDOSIN që ky Plan i Reagimit Emergjent është miratuar zyrtarisht; dhe

ËSHTË VENDOSUR DHE URDHËRUAR që Drejtori për Shërbime Publike dhe Emërgjencë, apo i emëruari i tij/saj, janë caktuar me detyrë dhe autorizuar ta mbajnë dhe rishikojnë/ripunojnë sipas nevojës këtë dokument, gjatë periudhës katër (4) vjeqare, apo derisa të urdhërohet ndryshe nga ky bord.

Kryetari i Komunës,

Kryesuesi i Asamblesë

VËRTETON:

Sekretari

Ky Plan i reagimit Emergjent, Miratohet me datën _____ 2025

Hyrje

Ky dokument është Plan Emergjent i **Komunës** së Gllogocit. Kriza dhe emergjenca mund të ndodh në çdo kohë dhe mund të godas një person, një ndërtesë të vetme apo tërë komunitetin. Emergjencat shkaktojnë konfuzion dhe stres për të gjithë të përfshirit në të. Në mënyrë që të minimizohen këto efekte, aktivizimi dhe implementimi fillestar i Planit të Reagimit Emergjent duhet të bëhet në mënyrë të qetë dhe të qëndrueshme. Implementimi efikas i planit do të ofroj drejtim të qartë, përgjegjësi dhe vijimsi të kontrollit, për zyrtarët kryesor dhe administratorët. Idea themelore e çdo Plani të Reagimi Emergjent të ndërtuar mirë është minimizimi i rreziqeve të mundshme ndaj individëve dhe të mirave materiale gjatë një emergjence. Me qëllim të zvogëlimit të rrezikut të një emergjence, duhet të bëhen vlerësime dhe përmirësime vjetore në planin emergjent.

QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI I PLANIT

Qëllimi i këtij plani është që të përshkruaj ato aktivitete që do të merren nga Kryetari komunës, i cili është përgjegjës për siguri publike dhe mirëqenie të qytetarëve në komun dhe:

- Është përgjegjës për koordinimin e resurseve komunale për adresimin e tërë spektrit të veprimeve të parandalimit, gatishmërisë, reagimit dhe rimëkëmbjes nga incidentet në kontekstin e të gjitha rreziqeve duke përfshirë fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
- Siguron udhëheqje dhe luan rol kyç në komunikim me publikun dhe ndihmën për njerëzit, bizneset dhe organizatat në përballje me pasojat e çdo emergjence brenda juridiksionit të komunës;
- Nxitë pjesëmarrjen në ndihmat reciproke dhe ushtron autoritetin e tij për të hyrë në marrëveshje për ndihmë reciproke me komunat tjera;
- Kërkon ndihmë qeveritare kur vlerësohet që kapacitetet komunale do të jenë të pamjaftueshme apo të rraskapitura.
- Cakton Komandantin e Incidentit me rekomandimin e Koordinatorit të Menaxhimit Emergjent.

Plani përbëhet nga: **Plani Bazik (themelor)**, i cili përshkruan parimet dhe doktrinën, njoftimet dhe doracakun e burimeve, e cila parashikon Listën kontaktuese, mjetet e nevojshme dhe burimet lokale; dhe një seri listash kontrolluese funksionale të cilat japin hollësi për realizimin e specifikave të operacionit dhe **Planeve**

specifike për Reagim Emergjent. Qëllimi i këtij plani është që të përfshin të gjitha aktivitetet në të gjithë ciklin e menaxhimit të emergjencave, duke përfshirë **parandalimin, përgatitjen, reagimin si dhe fazat e rimëkëmbjes.** Ky plan është i zbatueshëm për të gjitha organizatat që veprojnë për reagim ose në emër të komunës ose të qytetarëve (të Glogocit). “Planet e Incidenteve specifike” mund të shtohen në këtë plan nëse është e nevojshme, për të përballuar në mënyrë më efikase kërkesat e paraqitura nga rreziqet e veçanta. Planet e tilla janë të renditura në Shtojcat e këtij Planit.

Elementet e Planit

Ky plan përbëhet nga plani bazik, shtojcat, anekset e funksioneve mbështetëse emergjente dhe anekset e **Planeve për Reagime Emergjente për ngjarjet.** Planit bazik ofron një përshkrim të qasjes së **Komunës** ndaj reagimit dhe operacioneve emergjente. Shpjegon politikat, organizimet dhe detyrat që do të përfshihen në reagim ndaj një emergjence. Shtojcat japin definicionin e termeve dhe shkurtesave të përdorura në planin bazik dhe janë vend për çdo skicë, tabelë apo formë mbështetëse. Anekset e funksioneve mbështetëse emergjente përqendrohen në mënyrë të hollësishme në përgjegjësitë, detyrat dhe veprimet operative specifike për përmbushjen e funksionit të caktuar operativ emergjent, ndërsa anekset për incidente përqendrohen në çdo nevojë shtesë të planifikimit apo reagimit, përtej planit të reagimit bazik për skenarin e ngjarjeve të caktuara.

SHTRIRJA

Shtrirja përcakton reagimin ndaj emergjencave/fatkeqësive për të cilin plani u jep të drejt departamenteve, agjencive dhe komunave dhe lokaliteteve të bashkësive lokale.

Ky plan dhe të gjithë përbërësit e tij janë të aplikueshëm për tërë **Komunën e Glogocit.**

Personeli apo partnerët të cilët kanë detyra në këtë Plan do të kenë qasje dhe do të jenë të njoftuar me PRE.

II. SITUATA DHE SUPOZIMET


Territori i komunës së Glogocit shtrihet në pjesën e Kosovës qendrore, në luginën e Drenicës, 32 km nga Prishtina. Territori i saj shtrihet në mes të Rrafshit të Kosovës dhe atij të Dukagjinit. Territori i Komunës së Glogocit është një urë lidhëse në mes të këtyre dy rajoneve.

Komuna e Glogocit ka një sipërfaqe prej 275,63km² me një lartësi mbidetare prej: 575 m, pika më e ulët, dhe 1072 m, pika më e lartë.

Komuna e Gllogocit rrethohet me Malet e Berishës në pjesën Jug- Perëndimore, Kosmaqit në pjesën perëndimore, Qyqavicës në pjesën Veriore, Goleshit dhe Lipovicës (Blinajës) në pjesën Jug-Lindore. Këto male shtrihen në të dy anët e Luginës së lumit Drenica.

Sa i përket komunave fqinje, në veri kufizohet me Komunën e Skënderajit, në VL me atë të Vushtrisë, në lindje me komunën e Obiliqit dhe Fushë Kosovës, në JL me Lipjanin, në JP me komunën e Malisheves dhe në Perëndim me atë të Klinës.

Harta 1. Pozita gjeografike e komunës së Gllogocit në Kosovë,




Komuna e Gllogocit është e pozicionuar në qendër të Republikës së Kosovës, ngjashëm qyteti i Gllogocit është i pozicionuar në qendër të shtrirjes hapësinore të komunës. Kjo përparësi i mundëson që të gjitha vendbanimeve në komunë të kenë lidhje të afërta rrugore me qytet, si dhe i jep përparësi komunës së Gllogocit përmes lidhjeve të mira me të gjitha komunat në Kosovë.

Sipas regjistrimit të rrugëve në nivel komunal, gjatësia e përgjithshme e rrjetit rrugor është 570.20km, prej të cilave 512.5km janë rrugë lokale, 35.4km janë rrugë regjionale, 19.53km janë rrugë nacionale, si dhe 2.78km janë autoudhë. (Shënim: Gjatësia tek rrugët me 4 korsi është llogaritur vetëm me një anë të rrugës).

Në mungesë të kategorizimit të rrugëve (sipas normave të planifikimit apo Ligjit për Rrugë), të gjitha rrugët në menaxhim të Komunës janë të përcaktuara si rrugë lokale. Në mungesë të informatave, në analiza nuk janë të përfshira rrugët e kodrave apo rrugët e tokave bujqësore. Infrastruktura rrugore në komunë është kryesisht e modelit me dy korsi, përveç **rrugës nacionale Prishtinë-Pejë** në gjatësi prej 19.53km, si dhe segmentit të shkurtë të **autoudhës Rruga e Kombit** me gjatësi 2.78km të cilat janë me 4 korsi. Rruga nacionale Prishtinë-Pejë, segmenti i autoudhës, rrugët tjera nacionale dhe regjionale shërbejnë si nyje kyçe për transport rrugor dhe gjendja e tyre konsiderohet të jetë kryesisht e mirë.

Në total **rrjeti rrugor lokal** është në gjatësi prej 570.20km, prej tyre rrugë me **zhavorr** janë **3.55km (2%)** dhe të **asfaltuara** janë **507.146 (98%)** (shih shtojcën). Rrjeti rrugor lokal i komunës së Glogocit lidhet me rrjetin e rrugëve nacionale përmes rrugëve Prishtinë-Pejë dhe asaj regjionale Mitrovicë-Lipjan. **Kryqëzimet kryesore** në komunë janë në Komoran dhe në hyrje të Glogocit tek rrethi

Harta 2: Rrugët në Komunën e Glogocit



Sipas Planit të Vlerësimit të Rrezikut dhe analizës së rreziqeve në Komunën e Glogocit, rreziqet kryesore (*sipas prioritetit*) janë:

- **Vërshimet;**
- **Zjarret Fushore dhe Malore;**
- **Zjarret në Objekte Industriale dhe prodhuese;**

- Zjarret në Pompat e Derivateve të naftës;
- Aksidentet në komunikacion rrugor;
- Epidemitë, Endemitë dhe Pandemitë,

Ndërsa si rreziqe dytësore janë :

- Breshëri,
- Tërmetet
- Erërat,
- Erozionet,
- Ortekët etj.

Komuna në bazë të nenit **46, pika 2 dhe nenit 91 të** LIGJIT NR. 04/L-027 PËR MBROJTJE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA, është përgjegjëse për hartimin e Planit të Reagimit Emergjent dhe Menaxhimin e kapaciteteve reaguese për mbrojtjen e jetëve dhe të mirave materiale të banorëve nga pasojat e Fatkeqësive Natyrore dhe dhe Fatkeqësivë Tjera dhe atyre të shkaktuara nga faktori njeri.

Plani i Reagimit Emergjentë i Komunës është hartuar në pajtim me Ligjet:

1. LIGJIN NR. 04/L-027 PËR MBROJTJE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA;
2. LIGJIN NR. 08/L-261 PËR MBROJTJE NGA ZJARRI,
3. LIGJIN NR. 04/L-049 PËR ZJARRËFIKJE DHE SHPËTIM,
4. RREGULLORE Nr. 25/2012 PËR NORMAT TEKNIKE TË MBROJTJES NGA ZJARRI NË NDËRTIMIN E IMPIANTEVE PËR LËNGJET E NDEZSHME, DEPONIMIN DHE TOÇITJEN E TYRES,
5. RREGULLORE Nr. 24/2012 PËR NORMAT TEKNIKE PËR MBROJTJE NGA ZJARRI TË OBJEKTEVE TË LARTA,
6. RREGULLORE (QRK) - NR. 18/2015 PËR ORGANIZIMIN E NJËSIVE TË STRUKTURAVE PËR MBROJTJE, SHPËTIM DHE NDIHMË,
7. NË PAJTIM MË PLANIN E REAGIMIT KOMBËTARË,
8. STATUTIN E KOMUNËS SË GLLOGOCIT;

Ky plan do të punohet, përpunohet, ushtrohet, përmirësohet dhe ri-shpërndahet një herë në 3 vjet, por nuk përjashtohet mundësia që përpunohet apo përmirësohet.

Sipas identifikimit dhe Vlerësimit të Rreziqeve të realizuar për **Komunën e Gllogocit janë këto rreziqe:**

Rreziku	Shkallëzimi i karakterit
FNFT	
Shtrëngatë	Fare/Kufizuar/Mesatar/Kuptimplotë
Stuhi	Fare/Kufizuar/Mesatar/Kuptimplotë
Mot i Lig	Fare/Kufizuar/Mesatar/Kuptimplotë
Zjarr Fushoro/Malor	Fare/Kufizuar/Mesatar/Kuptimplotë
Zjarr në Objekte industriale dhe prodhuese	Fare/Kufizuar/Mesatar/Kuptimplotë
Mungesë e Resurseve	Fare/Kufizuar/Mesatar/Kuptimplotë
Tërmetet	Fare/Kufizuar/Mesatar/Kuptimplotë
Vërshimet	Fare/Kufizuar/Mesatar/Kuptimplotë
Nga Faktori Njeri	
Terrorizëm	Fare/Kufizuar/Mesatar/Kuptimplotë
Aktivitet kriminal	Fare/Kufizuar/Mesatar/Kuptimplotë
Vlerësim i Rrezikut të Brendshëm	Shkallëzimi i karakterit
Pandemi, Epidemi, Endemi	Fare/Kufizuar/Mesatar/Kuptimplotë
Lëndime në Mas	Fare/Kufizuar/Mesatar/Kuptimplotë
Trazir Civile	Fare/Kufizuar/Mesatar/Kuptimplotë
Incident Kimik	Fare/Kufizuar/Mesatar/Kuptimplotë
Incident Radiologjik	Fare/Kufizuar/Mesatar/Kuptimplotë
Incident Biologjik	Fare/Kufizuar/Mesatar/Kuptimplotë
Incident me Eksploziv	Fare/Kufizuar/Mesatar/Kuptimplotë
Incident Nuklear	Fare/Kufizuar/Mesatar/Kuptimplotë
Dështim i Komunikimit	Fare/Kufizuar/Mesatar/Kuptimplotë
Dështimi Infrastrukturës	Fare/Kufizuar/Mesatar/Kuptimplotë

Siqë po shihet në tabelë, rreziqet që dominojnë sipas **Shkallëzimit të Karakterit** e kemi theksuar me ngjyrë të gjelbert, prandaj treguesit e rreziqeve dhe vlerësimi i dobësive për ngjarjen e rreziqeve mesatare dhe

kuptimplote janë analizuar për **Komunën Gllogocit**. Treguesit e rreziqeve kanë vlerësuar shkallën e rrezikut ndaj të cilave është e ekspozuar komuna nga rreziqet përkatëse. Vlerësimi e cënueshmërisë ka llogaritur efektin e mundshëm nëse hapësira e caktuar do të goditet nga rreziku përkatës. Këto vlerësime janë të përshkruara në **Planin e Vlerësimit të Rreziqeve të Komunës**.

Vlerësimi i kapacitetit mund të përfshihet por edhe t'i referohet planit. Vlerësimi i kapaciteteve tregon forcën dhe aftësinë e personelit në procedurat emergjente, rëndësinë e sistemit të instaluar dhe testuar të alarmimit emergjent përgjat tërë komunitetit dhe ri-fuqizon nevojën e vazhdimit të përpjekjeve për integrimin e reagimit me planet reaguese të lokaliteteve në Komunën e Gllogocit.

Burimet: Vlerësimi i Gatishmërisë së Komunitetit Lokal

Ky proces është përdorë për të përcaktuar kapacitetet dhe kufizimet e komunitetit për tu përgatitur dhe reaguar ndaj rreziqeve të identifikuara. **VGKL** plotësohet mbi baza vjetore. **VGKL** mund të jetë mjet esencial dhe të përdoret për identifikimin e resurseve dhe gjithashtu të përdoret për identifikimin e fushave ku mund të ndërtohen Memorandume të Mirëkuptimit dhe Marrëveshjet Ndërkomunale për Ndihmë Reciproke.

Vlerësimi i kapaciteteve të **Komunës së Gllogocit** është realizuar prej vitit 2004, por i rishikuar në vitet 2010,-2019-2024 dhe tani po i rivlerësojm këto kapacitete në këtë **PREL**.

Parashikimet

Numri i popullsisë dhe vendbanimet janë një indikator i rëndësishëm për demografinë dhe i rëndësishëm për hartimin e PREL. Për të identifikuar numrin e popullsisë kemi shfrytëzuar të dhënat e regjistrimeve të popullsisë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). Në Kosovë regjistrimet zyrtare të popullsisë të fundit, janë bërë në vitin 2024. Pasqyrën e popullsisë së Komunës , vendbanimet, aspektet gjinore të Komunës së Gllogocit do ti paraqesim në tabeloret dhe diagramet e mëposhtme:

Tab. Nr. 1. Popullsia e Komunës së Gllogocit sipas gjinisë dhe etnive- 2024-ASK

Gjithsej	Gjinia		Etnia									
Komuna e Gllogocit	Meshkuj	Femra	Shqiptarë	Serbë	Turq	Boshnjak	Rom	Ashkali	Egjiptas	Goran	Të tjerë	Preferon të mos të përgjigjen
48079	24134	23945	48033	0	3	13	0	1	0	0	15	11

Tab. Nr.2. Popullsia e komunës së Drenasit sipas gjinisë dhe grup-moshave-2024-ASK

Komuna e Drenasit		Gjithsej	Grup-mosha						
			0-4	5-9	10-14	15-19	20-24	25-29	30-34
	Gjithsej	48079	3580	4000	4223	3959	4096	3363	3275
	Meshkuj	24134	1889	2082	2170	2044	2050	1668	1670
	Femra	23945	1691	1918	2053	1915	2046	1695	1605
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
35-39	40-44	45-49	50-54	55-59	60-64	65-69	70-74	75-79	80+
3350	3157	3111	2771	2487	2141	1759	1264	825	718
1712	1601	1487	1363	1188	1009	838	625	405	333
1638	1556	1624	1408	1299	1132	921	639	420	385

Përsona me aftësi të kufizuara, sipas shenimeve të marrura nga QPS (Qendra për Punë Sociale),

Tab.Nr.3. Numri i përsoneve me aftësi të kufizuar në komunë

Nr.	Mosha	Persona	Gjithësejt
1	0-18	107	538
2	18-70+	431	

Tab. Nr.4. Banesat sipas llojit, statusit të shfrytëzimit dhe tipit të vendbanimit në Komunë-PZHK

Lloji i objektit	Urban			Rural			Gjithësej		
	Banesa kolektive	Ekonomi Familjare	Banor	Banesa kolektive	Ekonomi Familjare	Banor	Banesa kolektive	Ekonomi Familjare	Banor
Banesë e zakonshme	2,636	2,653	12,315	7,165	7,225	35,764	9,801	9,878	48,079

Në trendet e popullatës të cilat do mund të ndikonin në implementimin e planit apo në reagimin emergjent përfshihen:

- **Plakja e popullatës: 9.5% i popullatës është mbi moshën 65 vjet(apo 4566 banor).**
- **90.5% i popullatës është nën moshën 65 vjet (apo 43513 banor).**

Nga këto statistika po shihet se përqindja e popullatës nën moshën 65 vjet është shumë e lart krahasuar me përqindjen mbi moshën 65 vjet, andaj duke vërejtur këtë përqindje të plakjes se popullsisë, nuk ndikon në implementimin e PRE.

Në tiparet e terrenit të cilat do mund të ndikonin në implementimin e planit përfshihen:

Lartësia mbidetare është prej 500-650m. Rreth 46% e sipërfaqes së territorit të komunës së Gllogocit gjendet në lartësinë mbidetare rreth 650m, lartësi kjo që është njëra ndër më të përshtatshmet për zhvillimin e prodhimtarisë bujqësore, ndërsa pika më e lartë është 1072m.



Lumi kryesor që kalon nëpër komunën e Gllogocit është Drenica, e cila është degë e majtë e lumit Sitnica dhe i takon pelgut të Ibrit. Ajo buron në Bretenc te mali Cërralejë. Drenica që nga Gllogoci e deri në Bardh i Madh, hyn në një pjesë të ngushtë, duke marrë pamjen e një gryke. Në këtë pjesë të lumit pjerrtësia është më e madhe, gjerësinë më të madhe (10 m) dhe me pjerrtësi të butë derdhet në Sitnicë. Prurja mesatare e lumit Drenica në Sitnicë është 2,0 m³/s. Drenica ka dhe degëzimet e veta siç është lumi Verbica. Në territorin e komunës së Gllogocit ndodhet edhe Liqeni i Vasilevës. Gjithashtu, në territor të komunës gjendet edhe burimi i ujit mineral në Poklek me temperaturë 13.0°C, pH 6.3., rrjedhje 1.00l/sec dhe mineralizim 3.52 si dhe ai në Vërboc, lagjja Istog. Sipërfaqen e tokës pjellore të Luginës së Drenicës e mbulon sistemi i ujitjes “Ibër-Lepenc”.

Klima - Kushtet klimatike janë mjaft të përshtatshme. Rajoni ka një klimë të mesme kontinentale me dimra të mesatarisht të ftohtë dhe verë të ngrohtë me ndikime të klimës mesdhetare. Kjo vie nga pozita e komunës

në mes të Rrafshit të Kosovës dhe atij të Dukagjinit. Rrafshi i Dukagjini ka klimë me ndikime mesdhetare nga deti Adriatik, kurse ai i Kosovës ka klimë kryesisht kontinentale. Temperatura mesatare vjetore është 10.6 °C, ku muaji më i ftohtë është janari me 0.8°C, kurse muaji më i ngrohtë është korriku me 20.6°C. Sasia mesatare e të reshurave është afër 670 mm, kurse në sezonin e vegjetacionit (prej muajit të IV-IX) afër 230 mm.

- Pjesa perendimore dhe veripërendimore në komunë është kodrinore në pjesën më të madhe të cilet mirren më buqësi
- Pjesa qendrore e komunës/qytetit është shumë urbane dhe me ndërtime të larta , por si zonë që mund të ndikohet nga vërshimet , është fshati Shtrubullo, Qikatove e re, dhe një pjesë e Poklekut të ri, pasi që kalon lumi Drenica, i cili në periudhat me shi, mund të shaktoj Vërshime.

Hartat 3: Llojeve të tokave dhe pjerrtësisë së terrenit në komunën e Gllogocit




D. Historiku i zonave të caktuara gjeografike në komunë, që janë më të ndjeshme ndaj efekteve të llojeve të rreziqeve parësore siq janë: **Vërshimet, Zjarret fushore dhe malore, zjarret në objektet industriale dhe**

ato prodhuese, Zjarret në pompat e derivative të naftës, Epidemitë, Endemitë dhe Pandemitë, por nuk do të thotë që komuna nuk mund të përfshihet/goditet/ edhe nga FNFKT, siqë janë: Tërmetet, Erërat, Breshëri, Thatësitë , Ortekët, Erozionet etj.

Zonat me të rrezikuara nga Vërshimet janë : **Drenas (Qendra e Re tregtare), Poklek i Ri, Poklek i Vjeter, Dobroshec, Nekoc, Komoran, Verboc, Terstenik, Fushticë e Ulet, Kizharekë, Arllat, Gllobar, Shtrubullovë**

Harta 4. Zonat me të rrezikuara nga Vërshimet në komunën e Gllgocit



Zonat me të rrezikuara nga Zjarret Malore dhe fushore në komunën e Gllogocit janë:

Malet e Gradicës dhe Godancit , Malet Dobroshecit , Malet e Abrisë, Pishat e Gllobarit, Malet e Sankocit, Malet e Gradicës , Korroticë e lart-Poklek-Vasilevë, ku në bazë të statistikave të marrura nga databaza e NJPSHZSH, nga viti 2014 -2025, kemi pasur **332** raste të zjarre malore dhe **1193** raste zjarre fushore, siq po shihet edhe në tabelë:

Tab.5. Numri i Zjarreve fushore dhe malore

VITET	Zjarre Fushore	Zjarre Malore	Siperfaqja (ha)
2014	51	8	1.7
2015	70	9	12
2016	14	7	1.7
2017	130	20	5
2018	51	18	29.82
2019	115	52	85.48
2020	77	35	33.28
2021	102	18	6.68
2022	87	38	92.65
2023	274	24	36.6
2024	222	66	45.6
2025		37	105.9
Gjithsej	1193	332	456.41

E. Trajnimet, Listat kontrolluese të reagimit dhe dokumentet shoqëruese të tjera, Janë në bazë të deklaratave 2 A., B., dhe C.D. Të këtij plani.

F. Bashkangjitur duhet pasqyruar asistencën tjetër të komunave dhe Qeverisë në pajtim me dispozitat e shkruara ndërqeveritare dhe ndihmë reciproke për mbështetje nga marrëveshjet në fuqi në kohën e emergjencave.

G. Kur burimet komunale janë plotësisht të angazhuara dhe ndihma është e dobësuar dhe zvogluar, atëherë **QOER**(*Qendra Operative Emergjente Regjionale*) është në dispozicion për koordinimin e mbështetjes, që të ndihmojë për të përmbush nevojat e paplotësuara. Në mënyrë të ngjashme, në qoftë se Regjioni, kërkon ndihmë shtesë, ajo mund kërkohet nga Regjionet tjera, në fund të fundit, mund të kërkon ndihmë nga Qeveria në lidhje me një fatkeqësi të jashtëzakonshme që nuk mund të menaxhohet nga komuna.

H. Në rast se ndodh një evakuim i banorëve të komunës, ose të ndonjë pjese të saj, shumica e të shpërngulurve do të përdorin burimet e tyre të transportit. Përveç kësaj, ata që posedojnë kafshë, kafshët

e tyre shtëpiake do ti transportojnë vet. Ata që posedojnë ferma blegtorale apo kafshë të tjera do të marrin masa të përshtatshme për evakuim.

I. Objektet me Rëndësi të veçantë (Speciale), personat juridik etj, do të zhvillojnë, koordinojnë dhe furnizojnë organizatat e Menaxhimit Emergjent të qytetit me planet e tyre operative emergjente të zbatueshme sipas kodeve, ligjeve, rregullave dhe kërkesave lokale dhe Shtetëror.

J. Çdo strukturë e rregulluar, fushat,(amandamentet dhe aktet ri- autorizuese), centralet elektrik, etj, që paraqesin një rrezik të veçantë, do të zhvillojnë, koordinojnë dhe furnizojnë me plane emergjente dhe procedura, agjencionet dhe drejtoritë lokale, regjionale dhe shtetërore, të zbatueshme sipas, kodeve, ligjeve, rregullave dhe kërkesave.

K. Kurdo që kërkohet, zyrtari i zgjedhur, do të deklarojë një emergjencë për komunën, në pajtim me dispozitat e Menaxhimit të Emergjencave. Në mënyrë të njejtë, në rast të ndonjë emergjence që kërkon veprime mbrojtëse (evakuim ose strehimin), zyrtarët e zgjedhur, do ta bëjnë rekomandimin dhe komunikojnë informacionin për popullsinë me mjet të përshtatshme duke përfshirë Sistemin Emergjent të Alarmimit (SEA), në linjë raportuese ose përmes teknologjive tjera.

L. Në rast se ndodh një shpërngulje, segmente të popullsisë do të duhet të transportohen nga zona e prekur identifikuar, në vend të sigurt. Varësisht nga faktorët e rrezikut, zonat për strehim mund të jenë të vendosura brenda ose jashtë komunës.

M. Strehimoret emergjente do të aktivizohen nga komuna duke përdorur strehimoret plotësuese si sallat sportive në shkollat publike / (sipas dispozitave të Ligjit për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera) ose strehimore tjera të caktuara në objektet e banimit (**bodrume**). Strehimoret do të jenë nën përkujdesjen e Komunës , Organizatave vullnetare aktive në fatkeqësitë, të tilla si: Kryqi i Kuq i Kosovës, OJQ-të, etj. Operatorët e strehimoreve në bashkëpunim me komunën, do të sigurojnë nevojat bazë duke përfshirë: ushqimin, veshmbathjen, strehimin, kujdesin mjekësor bazë, dhe të mbajnë regjistrin e banorëve në strehim.

N. Objektet Kritike, si, spitalet dhe objektet zgjeruara të kujdesit, duhet të kenë një nivel të jashtëzakonshëm alternativ të energjisë dhe burimeve të energjisë në dispozicion, për të akomoduar për situatat që kanë të bëjnë me humbjen e energjisë komerciale apo burimeve të tjera të energjisë.

III. ORGANIZIMI DHE CAKTIMI I (PËRGJEGJËSIVE)

Ligji për Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, parashikon që organizatat e shërbimeve emergjente dhe operacionet strukturohen rreth Ekzekutivit të Komunës.

Një program i suksesshëm lokal i menaxhimit emergjent përfshin zyrtarët e qeverisë lokale, agjencitë e qeverisë lokale, sektorin privat dhe organizatat jo profitabile. Rolet e tyre janë të përmbledhura në shtjellimet në vijim.

A. DREJTIMI

Zyrtarët e Zgjedhur-Kryetari i Komunës

- Mbrojnë jetët dhe pronat e qytetarëve;
 - Vendosin programin lokal të menaxhimit emergjent;
 - Caktojnë menaxherin emergjent lokal; dhe
 - Miratojnë dhe Shpallin Planin e Reagimit Emergjent Lokal (**PREL**).
- a. Janë përgjegjës për krijimin (vendosjen e një organizimi të Menaxhimit Emergjent komunal;
 - b. Sigurimin e vazhdimësisë së operacioneve;
 - c. Vendosjen e linjave të vazhdimësisë për postet kyçe;
 - d. Caktojnë QOEL të Shtabit/Komitetit për Mbrojtje dhe Shpetim dhe ato Alternative,
 - e. Përgatisin dhe mirëmbajnë këto QOEL në përputhje me Planin Operative Emergjente Qendrore,
 - f. Themelimin, dhe pajisjen e stafit të një QOE;
 - g. Rekomandojnë një Koordinator të menaxhimit emergjent (KME) për emërim në përputhje me Kodin e Shërbimit të Menaxhimit Emergjent;
 - h. Lëshojnë njoftimet për fatkeqësi emergjente dhe rekomandojnë veprimet mbrojtëse (evakuimin, ose vend strehimin) në qoftë se justifikohet situata, dhe
 - i. Aplikojnë për fonde shtetërore pas fatkeqësisë.

Themelimi i Planit të Lehtësimit / Zbutjes

Kryetari i Komunës apo i deleguari, Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë

- Përcakton nevojën për evakuim nga zonat e rrezikuara;
- Ushtron drejtimin dhe kontrollin nga QOEL gjatë operacioneve të fatkeqësive; dhe
- Mban përgjegjësinë e plotë për mirëmbajtjen dhe plotësimin e planit.

Koordinatori i Menaxhimit Emergjent

- Siguron që QOEL është në gjendje konstante të gatishmërisë;
- Harton dhe mirëmban PRE;
- Merr detyra të caktuara në mungesë të drejtorit të menaxhimit emergjent; dhe
Siguron që PREL, të rishikohet, plotësohet dhe përmirësohet çdo katër vjet

Drejtoritë Komunale

- Hartojnë dhe mirëmbajnë plane dhe procedura standarde operative (PSO);
- Përcaktojnë burimet e furnizimeve, pajisjeve dhe transportit emergjent;
- Negociojnë dhe mirëmbajnë marrëveshjet për ndihmë reciproke të përcaktuara në plan;
- Mirëmbajnë shënime dhe dokumente përkatëse të lidhura me shpenzimet për fatkeqësi;
- Mbrojnë dhe ruajnë shënimet/regjistrat esencial për vijimësinë e qeverisjes; dhe
- Krijojnë dhe mirëmbajnë listën e radhës së autoritetit të personelit kyç emergjent.

Funksionet Mbështetëse Emergjente (FME)

Një FME është grupim i kapaciteteve qeveritare/komunale dhe kapacitetet e caktuara të sektorit privat në një strukturë organizative për të ofruar mbështetje, resurse, implementim të programit dhe shërbime emergjente të cilat kanë më shumë të ngjarë të nevojiten gjatë emergjencave. Institucionet operative dhe Drejtoritë lokale marrin pjesë në strukturën e FME si koordinator, agjenci parësore të reagimit dhe/apo agjenci mbështetëse, sipas nevojës së mbështetjes së aktiviteteve të menaxhimit të incidentit.

FME-të:

- Hartojnë dhe mirëmbajnë plane të detajizuara dhe Procedura Standarde Operative (PSO) për t'i mbështet nevojat e tyre funksionale;
- Përcaktojnë burimet e furnizimeve, pajisjeve dhe transportit emergjent;
- Mbajnë shënime të sakta të dokumenteve për shpenzimet e lidhura me fatkeqësi;
- Vazhdojnë të jenë përgjegjës për mbrojtjen dhe ruajtjen e shënimeve/të dhënave esenciale për vijimësinë e qeverisjes; dhe
- Vendosin radhën e autorizimeve për personelin kyç emergjent.

Spektori Privat(Ndërmarrjet,institucionet dhe Organizatat tjera)

Me qëllim të zbatimit të detyrave specifike operative të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, Drejtoria për Shërbime publike dhe Emergjencë, mundë të angazhoj sektorin privat si: ndërmarrjet, institucionet dhe organizatat tjera, nëse ato janë në gjendje të sigurojnë personelin dhe pajisjet e nevojshme dhe të angazhoj:

- Pronar privat i infrastrukturës kritike;
- Organizëm reagues (si: shërbimi privat ambulator, shërbim i pastrimit ambiental, ndërmarrjet ndërtuese, etj);
- Palë e sistemuar apo përgjegjëse: operuesit e pronarëve të objekteve të caktuara të sistemuara mund të kenë përgjegjësi sipas ligjit të përgatiten për incidente dhe t'i parandalojnë ato, apo
- Pjesëar i organizatës lokale emergjente.

Spektori privat ka përgjegjësinë të:

- Sigurojnë trajnime për punëtorët e tyre dhe të përgatiten për veprim në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera. Të planifikoj për veten dhe veprimtarin e tij gatishmërinë, zvogëlimin, reagimin dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë;
- Të ketë njohuri për procedurat dhe planet lokale të reagimit emergjent; dhe
- Zbatojnë veprime mbrojtëse sipas nevojës apo me kërkesën e Menaxherit Emergjent Lokal apo komandantit të Incidentit.

1. Managjeri i Qendres Operative Emergjente Lokale (QOEL)- Koordinator i Menaxhimit Emergjent Lokal (KMEL):

- a. Përgatit dhe mban një objekt për QOEL të komunës, për shpalljen, rishikimet dhe informatat më të reja për zyrtarët e zgjedhur siç kërkohet;
- b. Mirëmban koordinim me Regjionin, dhe jep informata të menjëhershme për emergjencë, që ka në dispozicion;
- c. Në bashkërendim me Regjionin, identifikon dobësitë dhe rreziqet që mund të ndikojnë në komunë;
- d. Identifikon burimet brenda komunës të cilat mund të përdoren për t'u përgjigjur në një situatë emergjente apo fatkeqësi dhe u përgjigjet kërkesave për burime të nevojshme për ndihmë reciproke me partnerët ose regjionin;
- e. Zhvillon dhe mirëmban një staf të trajnuar për reagim emergjent aktual dhe një listë kontrolluese të përshtatshme për nevojat emergjente dhe burimet e komunitetit;
- f. Mobilizon QOEL dhe vepron ose delegon funksionet e Drejtimit (Komandës) në kuadër të QOEL gjatë një emergjence;
- g. Grumbullon shifrat e kostos për kryerjen e operacioneve Emergjente; dhe
- h. Ndjek trajnime dhe punëtori të siguruara nga regjioni dhe burimet tjera për të mbajtur në aftësi të përhershme Planifikimin dhe Procedurat e Reagimit Emergjent.

3. Zyrtari për Informim Publik Lokal (ZIP), (dhe çështjeve të jashtme - FME # 15)

- a. Zhvillon dhe mban një listë kontrolluese për funksionin e Informimit Publik.
- b. Ndihmon në zhvillimin, shqyrtimin dhe mirëmbajtjen e QOEL (*Qendra Operative Emergjente Lokale*);
- c. Informon nga QOLE ose në vendngjara sipas nevojës, lidhur me situatën Emergjente;
- d. Koordinon të gjitha informatat e lëshuara në publik apo në media me ZIP të regjionit dhe / Qendrën e Përbashkët të Informimit.

- e. Koordinon ndërgjegjësimin e publikut për informacion të mediave para një incidenti dhe siguron informata të sakta dhe në kohë për përgjigje dhe mëkëmbjen e operacioneve;
- f. Këshillon zyrtarët e zgjedhur të Informimit Publik dhe KMEL rreth aktiviteteve;
- g. Zhvillon dhe harton njoftimet e parapregaditura (të shkruara) për përdorim në një kohë të jashtëzakonshme;
- h. Zhvillon dhe shpërndan informacionin publik / materialet arsimore lidhur me masat që do të merren gjatë një emergjence duke përfshirë informacionet në lidhje me vend strehimin, rrugët evakuimit, vendet e strehimoreve, transportit edhe vendet e marrjes, etj;
- i. Punon si një pjesë e Qendrës për Informim të Përbashkët (QIP), të përcaktuar nga zyrtarët e Regjionit apo Shtetit.

4. Zyrtari për Siguri - Vëzhgon kushtet e sigurisë dhe zhvillon masat për të siguruar parrezikshmërinë e të gjithë personelit të caktuar.

5. Zyrtari Ndërlidhës - shërben si Kontakt i parë në mbështetjen e FME-ve për të ndihmuar në incident.

B. SEKTORI I OPERATIVËS (Koordinatori i Menaxhimit Emergjent lokal- KMEL), ose një i deleguar është përgjegjës për të siguruar përmbushjen e përgjegjësi të të gjitha degëve të caktuara. Shefi i Sektorit duhet të mbajë përgjegjësi, për drejtorët e degëve ose të deleguarit e tyre, varësisht nga situata dhe disponueshmërinë e personelit. Shefi i Seksionit koordinon punën në bazë të detyrave të caktuara nga drejtori i degës dhe raporton te menaxheri i QOEL për përparimin dhe statusin e misionëve të caktuara.

DETYRAT E DREJTORIVE, DEPARTAMENTEVE, SEKTOREVE DHE ZYRAVE

ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNIKIM DHE INFORMIM (ZKKI)

Komunikimi (FME # 2):

- a. Zhvillon dhe mban një listë kontrolluese për Funkcionimin e Komunikimit;
- b. Ndihmon në zhvillimin, shqyrtimin dhe mirëmbajtjen e QOEL;
- c. Trajnon anëtarë të stafit në funksionimin e sistemit të komunikimit;
- d. Siguron mundësinë për të komunikuar ndërmjet QOEL, operacioneve në terren dhe Regjionit;

- e. Ndhmon në njoftimin e qytetarëve të komunës;
- f. Reagon në QOE ose në vendin e Incidentit (fushë), sipas nevojës;
- g. Këshillon zyrtarët e zgjedhur të komunikacionit dhe KME rreth aktiviteteve dhe
- h. Kryen përgjegjësitë tjera të caktuar nga Shefi i Seksionit.

DREJTORIA PËR SHERBIME PUBLIKE DHE EMERGJENCË

2. Zjarrfikja (FME # 4):

- a. Zhvillon dhe mban një listë kontrolluese për funksionin e zjarrfikësve;
- b. Ndhmon në zhvillimin, shqyrtimin dhe mirëmbajtjen e QOEL;
- c. Reagon në QOEL ose në Vendin e Incidentit, sipas nevojës;
- d. Koordinon shërbimet e zjarrfikjes dhe shpëtimit;
- e. Merr përgjegjësinë primare për rrugët e njoftimit të publikut;
- f. Ndhmon në evakuimin e qytetarëve të prekur, veçanërisht atyre që janë të institucionalizuar, të bllokuar ose të plagosur;
- g. Ofron ndriqim emergjent dhe gjenerimin e energjisë për dritat;
- h. Ndhmon në operacionet e riaftësimit dhe pastrimin e copërave;
- i. Këshillon zyrtarët e zgjedhur dhe KMEL rreth aktiviteteve të zjarrfikjes dhe shpëtimit; dhe
- J. Kryen përgjegjësitë tjera të caktuar nga Shefi i Seksionit.

4. Kerkimi dhe Shpëtimi (FME # 9):

- a. Ndhmon në zhvillimin, shqyrtimin dhe mirëmbajtjen e QOEL;
- b. Reagon në QOEose në vendin e incidentit, sipas nevojës;
- c. Koordinon shërbimet e kërkimit dhe shpëtimit;
- d. Këshillon zyrtarët e zgjedhur dhe të KME rreth kërkimit dhe shpëtimit (K & Sh); dhe
- e. Kryen përgjegjësitë tjera të caktuar nga Shefi i Seksionit.

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI

3. Shëndetësia /Mjekësia (FME # 8):

- a. Zhvillon dhe mban një listë kontrolluese për funksionin e shërbimeve Shëndetësore / Mjekësore;
- b. Ndhmon në zhvillimin, shqyrtimin dhe mirëmbajtjen e QOEL;
- c. Reagon në QOEL ose në vendin e incidentit, sipas nevojës;
- d. Mirëmban një listë të banorëve me nevoja të veçanta, duke furnizuar me kopje komunën dhe Regjionin;
- e. Koordinon aktivitetet e urgjencës mjekësore brenda komunës;
- f. Koordinon nevojat institucionale për transport nëse bëhet e domosdoshme zhvendosja ose evakuimi për spitalet, shtëpitë e shëndetit, kujdesit ditor, shtëpitë e kujdesit personal apo kujdestarëve të objekteve;
- g. Koordinon shërbimet mjekësore të nevojshme për të mbështetur operacionet e Strehimit;
- h. Ndhmon në operacionet e kërkimit dhe shpëtimit;
- i. Ndhmon në shërbimet e morgut;
- j. Ndhmon në dispozitat e Vaksionimit për parandalimin e sëmundjeve;
- k. Këshillon zyrtarët e zgjedhur dhe KME rreth veprimtarive të Shëndetit Publik / Shërbimeve Mjekësore;
- l. Koordinon imunizimin e punëtorëve Emergjent;
- m. I referohet nevojave të Transportit (Kujdesi shëndetësor, Nevojave Speciale) ,për Zyrtarët e logjistikës;
- n. Koordinon dhe bashkëpunon me njësitë e përshtatshme dhe agjencitë lidhur me çështjet e shëndetit publik duke përfshirë edhe raportimin e sëmundjeve ngjitëse dhe krijimin e zonave karantinë; dhe
- nj. Kryen përgjegjësitë tjera të caktuar nga Shefi i Seksionit.

INSPEKTORIATI, ZJARRFIKJA DHE SHPËTIMI

5. Reagimi për Naftë dhe Materie të Rrezikshme (FME # 10):

- a. Ndhmon në zhvillimin, shqyrtimin dhe mirëmbajtjen e QOEL;
- b. Reagon Brenda QOEL ose në vendin e Incidentit sipas, nevojës;
- c. Koordinon me Ekipim për Materie të Rrezikshme siq është e përshtatshme;
- d. Koordinon dezinfektimin dhe dhe monitorimin e qytetarëve të prekur dhe punëtorëve emergjent pas ekspozimit nga rreziqet kimike ose radiologjike;

- e. Këshillon zyrtarët e zgjedhur dhe të KME rreth aktiviteteve për MAT.RREZ;
- f. Kryen përgjegjësitë tjera të caktuar nga Shefi i Seksionit.

POLICIA

6. Siguria Publike dhe Jorrezikshmëria - (FME # 13):

- a. Zhvillon dhe mban një listë kontrolluese për Siguri Publike dhe funksionimit të Sigurimit;
- b. Ndhmon në zhvillimin, shqyrtimin dhe mirëmbajtjen e QOEL;
- c. Reagon Brenda QOEL ose në vendin e incidentit, sipas nevojës;
- d. Koordinon shërbimet e sigurisë dhe zbatimit të ligjit;
- e. Krijon siguri dhe mbrojtje të objekteve të rëndësishme komunale, duke përfshirë QOEL;
- f. Siguron qasje dhe kontroll të trafikut për rreth dhe në zonat e prekura;
- g. Ndhmon përmes linjave të alarmimit dhe njoftimit për popullatën e kërcënuar;
- h. Ndhmon në evakuimin e qytetarëve të prekur, veçanërisht atyre që janë të institucionalizuar, ngujuar ose të plagosur;
- i. Ndhmon në instalimin e shenjave emergjente të jashtëzakonshme dhe paisjeve tjera të lëvizjes së trafikut;
- j. Ndhmon në operacionet e kërkimit dhe shpëtimit;
- k. Këshillon zyrtarët e zgjedhur dhe të KMEL për Siguri Publike dhe operacionet e Sigurimit;
- l. Themelon dhe siguron shërbimet e sigurisë të lokacioneve për strehim që operojnë në vende të komunës;
- m. Ndhmon operatorët për strehim në shfaqjen e klientëve me histori kriminale duke përfshirë kundërvajtësit seksual.
- n. Themelon patrullat e sigurisë për ndonjë zonë të evakuuar, nëse lejojnë kushtet;
- o. Bashkëpunon me agjencitë tjera të zbatimit të ligjit në lidhje me hetimet, sigurinë e vendit të krimit etj. dhe
- f. Kryen përgjegjësitë tjera të caktuara nga Shefi i Seksionit.

C. SEKTORI I PLANIFIKIMIT (Koordinatori i Menaxhimit Emergjent ose ndonjë i deleguar):

Është përgjegjës për të siguruar realizimin e Menaxhimit Emergjent sipas përgjegjësive. Shefi i Seksionit duhet mbajë përgjegjësi për drejtimin e degës ose të delegojë detyra, varësisht nga situata dhe disponueshmëria e personelit. Shefi i Seksionit koordinon punën dhe detyrat e caktuara nga drejtori i degës dhe i raporton menaxherit të QOEL në përparimin dhe statusin e misionëve të caktuara.

D. SEKTORI I LOGJISTIKËS (Kordinatori i Menaxhimit Emergjent ose një i deleguar):

Është përgjegjës për të siguruar përmbushjen e përgjegjësive të të gjitha degët e caktuara.

Shefi i Seksionit duhet të mbajë përgjegjësitë e drejtorit të degës, ose të delegojë ato, varësisht nga situata dhe disponueshmëria e personelit. Shefi i Seksionit koordinon punën me detyra e caktuara nga drejtori i degës dhe i raporton Menaxherit të QOE në përparimin dhe statusin e detyrave të caktuara. Sektori i Logjistikës gjithashtu siguron mbështetje logjistike për QOE (vetvetiu).

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE & SEKTORI PRIVAT**1. Transporti (FME # 1):**

- a. Ndihmon në zhvillimin, shqyrtimin dhe mirëmbajtjen e QOEL;
- b. Reagon në brenda QOEL ose në vendin e incidentit, sipas nevojës;
- c. Mirëmban një listë të burimeve të Transportit dhe informatat kontaktuese duke përfshirë kapacitetet në komuna;
- d. Koordinon burimet e furnizimit gjatë transportit emergjent;
- e. Këshillon zyrtarët e zgjedhur dhe KMEL rreth aktiviteteve të transportit dhe
- f. Kryen përgjegjësitë tjera të caktuar nga Shefi Sektorit.

2. Punët Publike dhe të Inxhinierisë (FME#3):

- a. Ndihmon në zhvillimin, shqyrtimin dhe mirëmbajtjen e QOEL;
- b. Reagon brenda QOEL ose në vendin e incidentit, sipas nevojës;
- c. Mirëmban një listë të Punëve Publike të aseteve dhe burimeve;
- d. Shërben si ndërlidhje në mes Punëve Publike të komunës dhe e QOEL;
- e. Koordinon caktimin e burimeve të Punëve Publike;
- f. Siguron informacion mbi ujë, kanalizimin, ndërtimit të rrugëve dhe riparimin, ingjineri, inspektimit të ndërtimit dhe të mirëmbajtjes;
- g. Këshillon zyrtarët e zgjedhur KMEL rreth punëve publike dhe veprimtarive Inxhinierike; dhe
- h. Kryen përgjegjësitë tjera të caktuar nga Shefi I Sektorit.

SEKTORI PËR MIRËQENIE SOCIALE DHE KRYQI I KUQ

Kujdesi Masiv, Strehimit dhe Sherbimeve Humane (FME#6):

- a. Ndhmon në zhvillimin, shqyrtimin dhe mirëmbajtjen e QOEL;
- b. Reagon BRENDA QOEL ose në Vendin e Incidentit, sipas nevojës;
- c. Ndhmon Administratorin Emergjent të Qarkut (FME # 6) në mbajtjen e një liste të Kujdesit masiv - objektet për Strehim duke përfshirë kapacitetet;
- d. Koordinon me Kryqin e Kuq të Kosovës dhe agjencive të tjera të përshtatshme;
- e. Përgjigjet në Kërkesat për kujdes Masiv – Strehim, në mbështetjen e regjionit gjatë emergjencave;
- f. Koordinon me **FME#1** (Transporti) dhe **FME#7** (Menaxhimi i Burimeve) në lidhje me çështjet e evakuimit;
- g. Këshillon zyrtarët e zgjedhur dhe KMEL rreth Kujdesit Masiv, shpërnguljen dhe veprimtarive të strehimit; dhe
- h. Kryen përgjegjësitë tjera të caktuar nga Shefi i Seksionit.

DREJTORIA E ADMINISTRATËS

4. Dega e Mbështetjes me Burime (FEM#7):

- a. Koordinon për materialet, shërbimet dhe objektet në mbështetjen emergjente;
- b. Zhvillon procedurat për urdhëra të shpejt për furnizime dhe pajisje dhe përcjell shpërndarjen dhe përdorimin e tyre;
- c. Merr pjesë në përgatitjen e Planit të Menaxhimit të Incidenteve;
- d. Lehtëson marrjen e furnizimeve emergjente për punëtorët duke përfshirë ushqimin, ujin, dhe nevojat themelore;
- e. Lehtëson blerjen e furnizimeve, siç kërkohet, me ushqim, ujë, dhe nevojat për operatorët e strehimit;
- f. Siguron, ndjek dhe koordinon burimet e transportit (autobusë, furgonë, ambulancat shtesë, kamionët, etj);
- g. Ngrit përqendrimin fushor për burimet e furnizimit dhe të transportit;
- h. Merr furnizime, Koordinon shpërndarjen e karburantit emergjent për furnizimin e automjeteve emergjente, objekteve kritike të përshtatshme për të evakuuar, si dhe;
- i. Kryen përgjegjësitë tjera të caktuar nga Shefi i Seksionit.

DREJTORIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

5. Dega e Burimeve Bujqësore dhe Natyrore (FME#11):

- a. Ndhmon në zhvillimin, shqyrtimin dhe mirëmbajtjen e QOEL;
- b. Reagon brenda QOE ose në V.I.(vendin e incidentit), sipas nevojës;
- c. Mban një listë për ushqimin dhe kujdesin e kafshëve dhe kontrollin e pasurive;
- d. Shërben si ndërlidhje në mes të QOEL dhe qështjeve të ushqimit për komunitetin;
- e. Koordinon shpërndarjen e informacionit për ushqimin dhe kujdesin e kafshëve dhe kontrollin e komunitetit;
- f. Këshillon zyrtarët e zgjedhur dhe KMEL e lidhur me e kujdesin bujqësor, të kafshëve dhe qështjet e

kontrollit;

g. Koordinon aktivitetet lokale për strehim të kafshëve me Zyrtarët e Regjionit me FME#11 dhe ekipin ndërlidhës Reagues për Kafshë;dhe

h. Kryen përgjegjësitë tjera të caktuara nga Shefi i Seksionit.

KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE

6. Dega e Energjisë (FME#12):

a. Ndhmon në zhvillimin, shqyrtimin dhe mirëmbajtjen e QOEL dhe furnizimin Alternativë me energji elektrike;

b. Reagon Brenda QOEL ose në V.I.(vendit të incidentit), sipas nevojës;

c. Mban një listë për energji dhe shërbime të pasurive;

d. Shërben si ndërlidhje në mes të QOEL dhe shërbimeve komunale të Energjisë dhe rifunksionlaizimin e rrjetit të furnizimit të energjisë elektrike;

e. Koordinon shpërndarjen e informacionit në mes të degës së Energjisë në komunë / shërbimeve komunale;

f. Këshillon zyrtarët e zgjedhur dhe KMEL të energjisë lidhur me / çështjet e dobishme,dhe

g. Kryen përgjegjësitë tjera të caktuar nga Shefi i Seksionit.

E. SEKTORI I FINANCIVE DHE ADMINISTRIMI (KMEL, zyrtarët e zgjedhur dhe / ose si të deleguar

ZKF): Është përgjegjës për të siguruar përmbushjen e përgjegjësiave të Rimëkëmbjes afatgjate dhe zbutjes se furnizimeve me ushqim, veshëmbathje dhe gjëra të tjera higjienike. Shefi i Seksionit duhet të të mbajë përgjegjësinë e drejtorit të degës, ose t'ua delegojë atyre, varësisht nga situata dhe disponueshmëria e personelit. Shefi i Seksionit koordinon punën e degës sipas detyrave të caktuara nga drejtori dhe përcjell raportet të menaxherit I QOEL për përparimin dhe statusin e misionëve të caktuara. Sektori gjithashtu mban regjistrimet e financës dhe personelit për aktivitetet reaguese.

DREJTORIA PËR PUNË DHE MIRËQENIE SOCIALE& DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

1. Rimëkëmbja së Komunitetit dhe zbutjes (FME #14):

a. Mbikëqyrë dhe mban nën kontroll të gjitha analizat e kostos financiare dhe Aktivitetet që lidhen me emergjencën;

b. Përcakton koston dhe të dhënat kohore të personelit;

c. Koordinon zhvillimin e vlerësimit të dëmit dhe raporton te AME të Regjionit;

d. Fillon planifikimi për rimëkëmbjen e funksioneve jetike të komunitetit, dhe

e. Kryen përgjegjësitë tjera të caktuara nga Shefi Seksionit.

A. Zyrtarët e zgjedhur (kryetari dhe drejtorë e drejtorive), janë përgjegjës për mbrojtjen e jetës dhe pronës së qytetarëve. Ata ushtrojnë mbikqyrjen primare dhe kontrollin mbi të katër fazat (parandalimin, përgatitjen, reagimin dhe rimëkëmbjen) e jashtëzakonshme për menaxhimin emergjent të aktiviteteve në kuadër të komunës.

B. Koordinatori Lokal i Menaxhimit Emergjent (KLME-Drejtori i Drejtorisë për Emergjencë dhe Siguri ose ndonjë drejtor tjetër i emëruar), do të veprojë në emër të zyrtarëve të zgjedhur. Qendra Operative Emergjente Lokale (QOEL) është caktuar nga komuna, dhe mund të aktivizohet nga Koordinatori i Menaxhimit Emergjent (KMEL) apo, zyrtarëve të zgjedhur gjatë një emergjence. Një zëvendës i KME-së dhe një QOE Alternative do të caktohen për të funksionuar në rastin kur KMEL primar dhe QOE nuk janë në dispozicion.

C. Ky plan përfshin parimet për "të gjitha rreziqet" sepse shumica e funksioneve të reagimit emergjent, janë të njëjta, pavarësisht nga rreziku. KME do të bëjë mobilizimin e burimeve të personelit që kërkohet sipas situatës emergjente..

D. KMEL dhe zyrtarët e zgjedhur do të bëjnë marrëveshje për ndihmë reciproke me komunitat fqinje për ndihmë reciproke emergjente nëse do të jetë e nevojshme..

E. Komuna do të pranojë dhe do të shfrytëzojë Sistemin e Integruar të Menaxhimit të Emergjencave (SIME) dhe të Sistemin e Komandimit të Incidenteve (shih më poshtë).

III. KONCEPTI I OPERACIONEVE

RENDITJA E VEPRIMIT

Ky seksion përshkruan menaxhimin e incidentit dhe veprimet që shkojnë nga kërcënimi, njoftimi fillestar, deri në fillim të koordinimit të përpjekjeve për të vlerësuar dhe të ndërprerë kërcënimin, përgatitjen për aktivizimin strukturës së FME-së, në vendosjen e burimeve për reagim dhe operacione në incident, dhe në mbështetje për rimëkëmbje. Këto veprime nuk ndodhin domosdoshmërisht në mënyrë të pjesëshme; shumë prej tyre janë në bashkëveprim, prandaj duhet të ndërmerren reagime individuale ose të shumfishta ndaj këtyre incidenteve.

ORGANIZIMI



Kur qendra operative emergjente lokale (QOEL) është e aktivizuar duhet të ketë koordinim midis menaxherit emergjent dhe komandantit të incidentit për të siguruar reagim të qëndrueshëm:


- QOEL ndjek strukturën e SKI (sistemi i komandimit të Incidentit) dhe
- FME duhet të lidhen me stafin e SKI.

1. **Komandanti i Incidentit (KI)**, do të trajnohet për vendin e incidentit në bazë të kërkesave të SIME-së (Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Emergjencave). Në mënyrë të njëjtë, stafi i QOEL gjithashtu do të jetë i trajnuar sipas kërkesave të (SIME-s).


2. **Post Komanda e Incidentit, në vendngjarje duke përdorur SKI;**

3. **Sistemi i Komandimit të Incidenteve (SKI)** duhet të ketë:


- Hark një drejtimësh të kontrollit (staf prej 3 -7. optimale është 5);
- Përgjegjshmëri të personelit (çdo person i raporton vetëm një person në zinxhirin e komandës); dhe
- Poste funksionale të stafuara vetëm kur është e nevojshme (përgjegjësitë për çdo post që nuk është i plotësuar (punonjës) mbetet që në të ardhmen të plotësohen me pozita më të larta.




Skema në vijim është Onogrami i stafit të një QOEL. Më shumë detaje duhet të ofrohen në anekset FME




Sektori i Operacioneve



Funksionet Mbështetëse Emergjente (FME-të) e Shërbimeve Emergjente




FME-të e Shërbimeve Humane





FME-të e Mbështetjes së Infrastrukturës

Shënim: Të gjitha juridiksionet kanë personel FME të mbështetjes së infrastruktures dhe mund të modifikohet sipas nevojës.



FME-të e Sektorit të Planifikimit



FME-të e Sektorit të Logjistikës**Sekuenca e Veprimit**

Ky seksion përshkruan veprimet e menaxhimit të incidentit duke filluar nga njoftimi fillestar i kërcënimit, tek përpjekjet e hershme koordinuese të vlerësimit dhe pengimit të kërcënimit, tek aktivizimi përgatitor i strukturës FME, deri tek dislokimi i resurseve në mbështetje të operacioneve të reagimit ndaj incidentit dhe operacioneve të rimëkëmbjes. Këto veprime nuk ndodhin patjetër sipas radhës; shumë prej tyre mund të ndërmerren njëkohësisht në reagim ndaj kërcënimeve apo incidenteve të vetme apo të shumfishta.

Operacionet e Zakonshme/ Jo-emergjente

Këto janë veprime që zbatohen gjatë fazës jo-emergjente ose periudhat fatkeqësie që do të përgatisin potencialet lokale për reagim nëse është e nevojshme.

Këto janë veprime të cilat implementohen gjatë periudhave jo-emergjente të cilat do ta përgatisin lokalitetin për reagimin e mundshëm emergjent, nëse bëhet i domosdoshëm.

1. Pajisja e publikut me informacione dhe materiale edukative nëpërmjet gazetave lokale, broshurave, publikimeve në numratorët telefonik, veb-faqeve të komunës dhe mediave tjera.
2. Hartimi, shqyrtimi dhe stërvitja e planeve operative emergjente dhe procedurave standarde operative.

3. Sigurimi i saktësisë dhe besueshmërisë së listave të kontakteve emergjente, listave të resurseve dhe të kontraktuesve emergjent.
4. Plotësimi, rishikimi dhe mirëmbajtja e Planit të Reagimit Emergjent (PRE).
5. **PRE** lokal duhet të përfshijë dispozitën që siguron që të kontaktohet Departamenti i Shërbimeve të Judikaturës Kriminale dhe e Kompenzimit të lëndimeve Kriminale në rast të një emergjence ku ka viktima të llojit të përcaktuar sipas ligjeve në fuqi.

VEPRIMET PARA-INCIDENTEVE-ALARMIMI DHE PARALAJMERIMI

Këto janë veprime që zbatohen në qoftë se Menaxheri Emergjent merr njoftimin për një ngjarje të jashtëzakonshme nga Qendra e Situatave ose paralamërime tjera nga burime të besueshme.

Veprimet për:

Komunikimi i njoftimeve dhe paralajmërime;

- *Shëndeti dhe siguria publike;*
- *Shëndeti dhe siguria e reaguesve;*
- *Mbrojtja e pronave; dhe*
- *Aktivizimi i pjesshëm i mundshëm i QOEL (sipas llojit të emergjencës).*
- *Raporti i domosdoshëm për situatën para organeve të qeverisë lokale*
- *Alarmo personelin e menaxhimit emergjent dhe cakto modelin e plotësimit me personel.*
- *Përcaktoni masat mbrojtëse që duhet të implementohen në përgatitje për situatën.*

VEPRIMET REAGUESE

Shembuj të reagimit dhe të veprimeve të ndërmarra për të ruajtur jetën, pronën, mjedisin, dhe gjendjen sociale, ekonomike, politike dhe struktura e këtij komuniteti.

- *Zbatimi i ligjit;*
- *Mbrojtja e shëndetit dhe sigurisë së reaguesve;*
- *Zjarrfikja;*
- *Shërbimet mjekësore emergjente;*
- *Evakuimet;*

- *Shpërndarja e informacioneve publike;*
- *Veprimet për zvogëlimin e dëmeve shtesë;*
- *Kërkimi dhe shpëtimi urban;*
- *Shëndeti publik dhe shërbimet mjekësore;*
- *Shpërndarja e furnizimeve emergjente;*
- *Pastrimi i rrënojave; dhe*
- *Mbrojtja dhe restaurimi i infrastrukturës kritike.*

Disa çështje që duhet marrë në shqyrtim në këto momente gjat incidentit janë:

1. Funksionet ditore të qeverisë që nuk kontribuojnë drejtpërdrejt në operacionet emergjente, mund të jenë të pezulluara gjatë kohëzgjatjes së reagimit emergjent.
2. Përpjekjet dhe burimet mund të jenë të ridrejtuar për të kryer një detyrë emergjente.
3. Zbatimi i evakuimit urdhërohet sipas nevojës.
4. Strehimoret e nevojshme hapen nga personeli i reagimit emergjent.

VEPRIMET E RIMËKËMBJES

Këto veprime do të ndodhin pasi është zbatuar reagimi fillestar. Këto veprime do të ndihmojnë individët dhe komunitetet të kthehen në një qeverisje normale sa më shumë që është e realizueshme. Disa nga veprimet që mund të ketë nevojë të zbatohen gjatë periudhës së rimëkëmbjes janë:

- **Vlerësimi preliminar i dëmeve**
- **Veprimet afatgjata të rimëkëmbjes;**
- **Pastrimi dhe rindërtimi i objekteve publike, bizneseve, dhe vendbanimeve;**
- **Ri-vendosja e banorëve dhe parandalimi i mëvonshëm i dëmeve të burimeve natyrore;**
dhe
- **Mbrojtja e vendeve kulturore dhe arkeologjike gjatë operacioneve tjera të rimëkëmbjes;**

Qështjet tjera gjatë operacioneve të rimëkëmbjes:

Hapja e një zyre të përbashkët fushore (ZPF), për të ndihmuar të prekurit nga fatkeqësia në qoftë se një ngjarje është deklaruar si Fatkeqësi (shtetërore apo lokale). Kjo zyrë është pika qendrore e komunikimit mes agjencive të shtetit dhe atyre lokale, si dhe organizatave vullnetare për kryerjen e programeve të asistencës së rimëkëmbjes.

1. Brenda 72 orëve të goditjes, bëhe Vlerësimi fillestar i dëmeve dhe paraqitet në QOEL (Qendra Operative Emergjente lokale).
2. Bëhet vlerësimi i e infrastrukturës kritike lokale dhe të përcaktimi i realizueshmërisë për ri-hyrje të banorëve.
3. Fillim i menjëhershëm i riparimeve elektrike, ujit të pijshëm, kanalizimeve, linjave, stacioneve etj.

Veprimet e zbutjes (zvogëlimit të rrezikut)

Këto veprime bëhen për të zvogëluar apo eliminuar rreziqet afat-gjata ndaj njerëzve dhe të mirave materiale dhe efektivitetit të tyre anësor. Gjatë procesit të zbutjes, do duhej të adresohen këto çështje:

- *Grantet e programeve për masat e zvogëlimit të humbjeve (nëse janë);*
 - *Shpërndarja e ekspertizës shkencore për zvogëlimin e humbjeve në ndërtime;*
 - *Koordinimi me operacionet e Sigurimeve Qendrore për Përmbajtje dhe integrimi i zbutjes me përpjekjet tjera të programit;*
 - *Bërja e pasqyrimin të rimëkëmbjes nga përmbajtjet në hartë për të siguruar implemtim të shpejtë dhe të saktë të programeve të rimëkëmbjes ashtu edhe të zbutjes;*
 - *Modelimi parashikues për mbrojtjen e aseteve kritike;*
 - *Dokumentimi i hershëm i humbjeve të shmangura si rezultat i masave paraprake të zvogëlimit të rreziqeve; dhe*
 - *Edukimi publik dhe tejkallimet e domosdoshme për zvogëlimin e humbjeve.*
-
- *Rishikoni Planin e Zvogëlimit të të gjitha Rreziqeve dhe plotësoni sipas nevojës çdo veprim zbutës i cili do të mund të jetë i dobishëm në parandalimin e efekteve të ngjashme nga fatkeqësitë e ardhshme.*
 - *Punoni me Programin e Zbutjes të Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjent për zhvillimin e projekteve për grante të zbutjes për të ndihmuar në fushat më të rrezikuara.*
 - *Implementoni masa zbutëse në rindërtimin e infrastrukturës së dëmtuar.*

Shpallja e Gjendjes së Gatishmërisë

Komiteti për Mbrojtje dhe Shpëtim do të do të ngrisë gjendjen e gatishmërisë sipas niveleve me vendim, kurdoherë që **kërcënimi** apo **dukuria aktuale** e fatkeqësisë është apo kërcënon të jetë e ashpërsisë dhe madhësisë së atillë e cila kërkon shpenzime domethënëse dhe reagim të koordinuar me qëllim të parandalimit apo lehtësimit të dëmit, humbjeve, mjerimit apo vuajtjeve. Niveli i gatishmërisë mund të shpallet nga Kryetari apo delegimi i tijë tek Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë në pajtim me Bordin e Drejtorve. Nëse Bordi i Drejtorve, të cilin e kryeson Kryetari i i komunës, nuk mundë të mbledhet për shkak të fatkeqësisë apo rrethanave tjera urgjente, drejtori apo në mungesë të tij zëvendës drejtori duhet ta shpallë ekzistencën e një emergjence.

Aktivizimi i Qendrës Operative Emergjente (QOEL)

Menaxheri Emergjent apo koordinatori mund ta aktivizon QOEL nëse ekzistojnë rrethanat në vijim:

- Kur ekziston kërcënim i pashmangshëm ndaj sigurisë apo shëndetit publik në shkallë të gjerë;
- Kur është i nevojshëm një reagim dhe koordinim i gjerë i shumë agjencioneve/juridiksioneve për zgjidhjen e një ngjarje emergjente/fatkeqësie apo rimëkëmbjen nga ajo;
- Kur fatkeqësia godet shumë nën ndarje politike brenda komunave apo qyteteve, të cilët varen nga po të njëjtat resurse për zgjidhjen e ngjarjeve të mlëdha emergjente; dhe/apo
- Kur për kontrollin e ngjarjeve të mëdha emergjente apo fatkeqësie implementohen direktivat emergjente lokale.

Disponueshmëria e stafit dhe nevojave operacionale mund të lejojnë apo kërkojnë që të kombinohen/bashkohen, apo të mos plotësohen pozitat (përgjegjësitë barten nga pozicioni tjetër i lartë).

Komunikimi, Alarmimi dhe Paralajmërimi do të sigurohet për publikun përmes Sistemit të Alarmimit Emergjent (SAE). Sistemet tjera do të përdoren sipas mundësisë.

F. Kur QOEL komunale është aktivizuar, KME(Kordinatori i Menaxhit Emergjent) do të bëjë kordinimin mes K.I. (Komandanti i Incidentit) në V.I (Vendin e Incidentit) dhe AME (Agjencioni i Menaxhimit Emergjent). Për të siguruar përputhshmëri me operacionet në vendin e incidentit, QOE gjithashtu do të ndjekë një Strukturë të komandës së Incidentit. KME do të marrë rolin e Managjerit të QOEL (Drejtimi) dhe, fillimisht, të gjitha rolet e zbraza, deri sa personeli shtesë të mbërrijë në QOE, që KME të mund tua delegojë aktivitetet e tyre.

G. Pamjaftueshmëria e stafit dhe nevojat operacionale mund të lejojnë apo kërkojnë poste të kombinuara, ose pozitat të mos jenë plotësuar duke mbajtur përgjegjësitë për pozicionet e ardhshme të larta.

H. Diagrami i mësipërm është i ngjajshëm me Funksionet Mbështetëse Emergjente (FME) sipas stafit të SKI-së. Kjo shtrirje mund të modifikohet siç kërkohet nga situata e fatkeqësisë ose nevojave politike apo programatike të komunës.

I. Vazhdimësia e procedurave të qeverisë janë të specifikuar në listën e plotë të zyrtarëve të zgjedhur.

J. Kur KME merr njoftimin për një emergjencë nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent ose Shërbimi Kombëtar sinoptik dhe sizmik, ose nga burime të besueshme të tjera, do të vie në konsiderim aktivizimi i pjesëshëm i QOE, dhe do të konsiderohet si gadishmëri emergjente.

K. Komunikimi, Vërejtja dhe alarmimi, do të i sigurohen publikut nëpërmjet Sistemit Emergjent të Alarmimit (SEA), gjithashtu do të shfrytëzohen edhe Sistemet tjera në dispozicion.

L. Gjatë kohës jo-emergjente, informacionet në lidhje me planet e emergjente dhe veprimet që do të merren nga ana e publikut, në formën e informimit publik, dhe materialeve edukuese, do të sigurohen për publikun, nëpërmjet gazetave komunale, broshurave, drejtorive të botimeve telefonike, ueb - faqeve komunale, etj.

M. Në rast se ndodh një evakuim (largim), popullsia (apo segmente të saj) do të evakuhet duke përdorur makinat e tyre, ose do të transportohen nga zona e prekur e identifikuar në vend të sigurt. Varësisht nga faktorët e rrezikut, zonat strehuese mund të jenë të vendosura Brenda ose jashtë komunës.

N. Të shpërngulurit pritet të ndjekin drejtimin dhe udhëheqjen e punëtorëve emergjent, koordinatorëve të trafikut, dhe zyrtarëve tjerë të caktuar emergjent. Rrugët e caktuara Para-evakuimit do të shfrytëzohen kurdo që janë të sigurta dhe praktike. Sektori kritik do të jetë në staf të personelit të kontrollit të trafikut për të lehtësuar një rrjedhë të organizuar të trafikut.

O. Punëtorët Emergjente duhet kompletuar "planet familjare" para emergjente në adresimin e çështjeve të tilla si transporti dhe vendin e evakuimit të menjëhershëm për anëtarë të familjes (bashkëshorti/ja dhe fëmijët).

V. ADMINISTRATA DHE LOGJISTIKA

Në këtë seksion duhet të adresohen me sa vijon:

- *Referencat për Marrveshjet e Ndhmës Reciproke;*
- *Autorizimet dhe politikat mbi shtimin e stafit nëpërmjet riemrimit dhe aftësimit të stafit, kërkimin e vullnetarëve së bashku me provizionet përkatëse të detyrimeve;*
- *Politikat e përgjithshme mbi mbajtjen e shënimeve financiare, raportimin, përcjelljen e nevojave të resurseve, përcjelljen e burimit dhe përdorimit të resurseve dhe përfitimin e pronësisë mbi resurset.*

Të gjitha asetet (resurset humane dhe objektet dhe resurset e pajisjeve) e komunitetit do të bëhen fushveprim i /Kryetarit të Komunës së Gllogocit për t'i drejtuar në çfardo mënyre për të reaguar ndaj një emergjence.

Kryetari i Komunës gjithashtu mund ta caktoj këtë autoritet tek i emruari i tij apo tek **Koordinatori i Menaxhimit Emergjent** ashtu siç shkruhet në dosjen e Delegimit të Autoritetit.

Përcaktoni politikat dhe procedurat për përcjelljen dhe raportimin e çdo shpenzimi për shkak të emergjencës. Në shumicën e rasteve, politikat e zakonshme të prokurimit dhe financimit do të mbesin në fuqi, por në rastet e jashtzakonshme, duhet të ndiqen provizione shtesë për ta rritë shpejtësinë e këtyre veprimeve.

*Përcaktoni procedurat e nevojshme për përcjelljen dhe mbajtjen e shënimeve që do të përdoren për të siguruar të gjitha kostot emergjente të identifikohen lehtë. Këto çështje janë të shtjelluara më thellësishtë në **Tab 1 të Aneksit të Funksionit Mbështetës Emergjent #5.***

A. Administrata

1. Komunitat do të paraqesin raportet e situatës, kërkesat për ndihmë dhe raportet e vlerësimit të dëmit në QOR (Qendrat Operative Regjionale);
2. QOEL (Qendrat Operative Emergjente Lokale) do të dërgojnë raporte dhe kërkesa për ndihmë në QOER/AME;
3. Komunitat dhe QOER do të shfrytëzojnë llogarimbajtjet e para-krijuara dhe metodat e kontabilitetit për të gjetur dhe për të ruajtur të dhënat e shpenzimeve dhe detyrimeve;

4. Do të radhisin dhe shkruajnë llojet e regjistrave të aksioneve të ndërmarra nga ana e Drejtorisë për Emergjencë dhe siguri. Logot dhe shënimet e do të formojnë bazën për statusin e raporteve të Nivelit lokal dhe Regjionit.

5. Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë do të bëjnë raporte me kohë dhe në mënyrë më praktike për AME-në.

6. Të gjitha të dhënat me shkrim, raportet dhe dokumentet tjera do të ndjekin parimet e SIME-së.

B. Logjistika - Koordinimi i nevojave të paplotësuar:

Kur burimet komunale janë të angazhuara dhe ndihma reciproke është e konsumuar, QRAKE është në dispozicion për koordinimin e asistencës dhe të plotësojë nevojat e paplotësuar. Në mënyrë të ngjashme, në qoftë se Regjioni kërkon ndihmë shtesë, ai do të thërrasë në ndihmë reciproke nga Regjionet fqinje. Në fund të fundit, Regjioni do të kërkojë ndihmë nga AME, në lidhje me një fatkeqësi të madhe apo të jashtëzakonshme.

VI. Zhvillimi dhe Mirëmbajtja e Planit

Ky seksion përshkruan qasjen e përgjithshme të planifikimit, pjesëmarrësit e përfshirë në procesin e planifikimit dhe mënyrën me të cilën do të mirëmbahet dhe plotësohet plani.

Duhet të caktohet një person për t'i koordinuar këto punë dhe për t'i adresuar shqyrtimet, testimet dhe përmirësimet e rregullta.

Ligji për Mbrojtje nga FNFT, obligon juridiksionet që të zhvillojnë, miratojnë dhe mbajnë plane aktuale të shkruara të menaxhimit emergjent;

Çdo dy , tre apo katër vjet, **Komuna** do të zhvilloj shiqim gjithpërfshirës të planeve të menaxhimit emergjent për të siguruar që ato të mbeten aktuale dhe që planet e përmirësuar të miratohen formalisht nga Bordi i Drejtorëve.

Shikimet e tilla gjithashtu do të certifikohen me shkrim tek Departamenti i Menaxhimit Emergjent.

Draftimi i një plani emergjent është përpjekje e komunitetit dhe mbështetet fuqishëm në administratorët e **Qyteteve/Komunave** dhe ekspertët për të siguruar udhëzime gjithpërfshirëse lidhur me analizën e

rreziqeve, dizajnimin e ushtrimeve, planifikimin e evakuimeve, menaxhimin emergjent, zbutjen, rimëkëmbjen, gatishmërinë emergjente dhe vetëdijësimin edukativ.

Shembuj të pjesëmarrësve të planit:

- *Koordinatori i Menaxhimit Emergjent*
- *Punët Publike*
- *Përfaqësuesit e grupeve të brendshme:*
 - *Spektori i Financave,*
 - *Spektori i Resurseve Njerëzore,*
 - *Spektori i Blerjes, dhe*
 - *Organizatrat studentore.*
- *Përfaqësuesit e grupeve të jashtme:*
 - *Shërbimet Emergjente Mjekësore të lokalitetit,*
 - *Shërbimi i Zjarrfikësve dhe shpetimit,*
 - *Njësia e Policisë së lokalitetit/Komunitetit,*
 - *Qendrat Mjekësore,*
 - *Kryqi i Kuq,*
 - *OJQ-të, dhe*
 - *Tjetër.*

Koordinatori i Menaxhimit Emergjent do ta plotësoj Planin e Reagimit Emergjent çdo vit. **Koordinatori** do të koordinoj me secilën organizat të resurseve emergjente dhe siguroj zhvillimin dhe mirëmbajtjen e një kapaciteti të duhur të reagimit emergjent.

Është përgjegjësi e Koordinatorit të Menaxhimit Emergjent për të siguruar që plani është i testuar dhe ushtruar sipas orarit të paraparë.

Shembull i një orari të ushtrimeve:

Është e zakonshme që ushtrimet funksionale për disa pjesë të planit planifikohen të mbahet për çdo 6 muaj; Ushtrimet e ashtuquajtura në Tavinë mbahen çdo gjysëm viti; dhe ushtrimet në shkallë të gjerë mbahen çdo vit, ndërsa ushtrimet për tërmete dhe vërshime çdo 2 vjet.

Koordinatori do ta mirëmbaj orarin dhe do të siguroj që resurset e nevojshme të jenë në dispozicion për t'i kryer këto aktivitete.

Pas çdo stërvitjeje, ushtrimi apo ngjarjeje aktuale, do të zë vend një diskutim i nxehtë dhe/apo shqyrtim dhe analizë pas veprimit. Çdo gjetje nga këto analiza të pas-ngjarjes do të inkorporohen në plan me rastin e plotësimit të tij.

VI. TRAJNIMI DHE USHTRIMET

A. Autoriteti i Trajnimeve

Përsonei i trajnuar dhe i aftë është esencial për ekzekutimin e drejt të Planeve Operative Emergjente dhe nën planeve të Komunës. Drejtori i Mbrojtjes dhe shpëtimit, drejtoritë tjera OJQ-te dhe sektori privat do të sigurojnë që i gjithë personeli reagues dhe mbështetës ka kuptim të plotë të përgjegjësisë të tyre të caktuara për situatat emergjente, sikurse edhe se si rolet dhe përgjegjësitë e tyre ndërlidhen me komponentet tjerë reagues të PRE të Komunës. I gjithë personeli do të pajiset me trajnimet e nevojshme për ekzekutimin e këtyre përgjegjësisë në një mënyrë efektive dhe të përgjegjëshme.

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë është përgjegjëse për zhvillimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e programit gjithpërfshirës të trajnimeve dhe ushtrimeve të përshtatshëm për nevojat e Komunës. Ky program do të jetë i përbërë prej trajnimeve të përgjithshme, kryesore, specifike për funksione, si dhe si një program i vazhdueshëm rikujtues i dizajnuar për arritjen dhe mbajtjen e një niveli të pranueshëm të gatishmërisë emergjente për Komunën.

Trajnime do të bazohet në udhëzimet qendrore. Instruktorët do të përzgjidhen nga stafi dhe zyrtarët qeveritar të Komunës, qeveria qendrore, bizneset private, FSK-ja dhe grupet vullnetare të trajnuara në shërbimet emergjente dhe reagim emergjent. Të gjitha trajnimet dhe ushtrimet e zhvilluara në Komunë do të dokumentohen. Nevojat për trajnime do të përcaktohen dhe mbahen shënime për tërë personelin e ngarkuar me detyra të reagimit emergjent në fatkeqësi.

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë do të ndërtoj, planifikoj dhe zhvilloj për çdo vitë ushtrime në tavolinë, funksionale dhe në shkallë të gjerë. Këto ushtrime do të jenë të destinuara jo vetëm për testimin e Planit Operativ Emergjent dhe nën-planeve të Komunës por për t'i trajnuar të gjithë zyrtarët përkatës, personelin e reagimit emergjent, të punësuarit e Komunës dhe për përmirësimin e organizimit të përgjithshëm reagues dhe kapacitetit të Komunës.

Grupet gjysëm publike dhe vullnetare dhe/apo agjencitë do të inkurajohen të marrin pjesë. Mangësitë e identifikuara në ushtrime do të adresohen menjëherë.

Për qëllime të trajnimit dhe ushtrimeve, duhet aktivizuar këtë plan, për të vlerësuar dhe mirëmbajtur gjendjen e gadishmërisë së komunës siç kërkohet.

B. Kërkesat për Ushtrim

Të sigurohen praktika dhe përvoja për të kontrolluar operacionet për ata që kanë përgjegjësi në QOEL, kurse KMEL duhet të aktivizojë këtë plan të paktën çdo tre vjet në formën e një stërvitjeje (Ushtrimi), emergjent.

C. Trajnimi- Linjat e Veprimit

1. Trajnimet për Zyrtarët Publik:

a. Trajnimi i Reagimit dhe Rimëkëmbjes:

Programet e trajnimit do t'u ofrohen këtyre zyrtarëve komunal, koordinatorit të Menaxhimit Emergjent Lokal, personelit të QOEL dhe personelit të shërbimeve emergjente (të policisë, zjarrfikjes dhe dhe Funksioneve Mbështetëse Emergjente), mbi politikën dhe procedurat për një reagim të koordinuar dhe sanimin e një fatkeqësie të jashtëzakonshme. Programet e trajnimit të ofruara nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent të Kosovës dhe të koordinuar me Regjione dhe Komuna.

b. Zhvillimi Profesional:

Programet e trajnimit do t'i ofrohen komunës dhe stafit të OJQ-ve dhe Sektorit privat për aftësimin dhe teknikat e të shkruarit të planeve, zhvillimin e aftësive profesionale, dhe çështjet e sigurisë në lidhje me përgatitjen komunale për Emergjencë. Programet e trajnimit do të ofrohen nga AME-ja, dhe do të koordinohen nga QOER dhe Kuvendi Komunal.

c. Vlerësimi i Dëmeve dhe Raportimi:

Trajnimet Vjetore do të ofrojnë proozimet për procedurat raportuese të dëmeve, si dhe në vlerësimin e dëmit për personelin që do të punojnë me ekipet regjionale në vlerësimin e dëmeve. Programet e trajnimit do të ofrohen nga AME-ja dhe do të koordinohen nga Regjioni dhe komuna.

2. Shërbimet Emergjente dhe Agjencitë tjera Reaguese;

Ushtrimet, siç tregohet më lartë, do të përdoren si një teknikë për trajnimin e zyrtarëve të zgjedhur dhe të emëruar, stafit Emergjent lokal dhe Regjional, dhe personelit të shërbimeve, të cilëve u janë caktuar përgjegjësitë Emergjente në këtë plan. Stafi i Drejtorive, inspektoriatit, sektorit privat dhe OJQ-ve, përgjegjës për anekset funksionale, janë të ngarkuar për sigurimin e aftësive, për trajnimin e personelit të cilët zbatojnë dispozitat e tyre në anekset përkatëse.

3. Trajnimit Shtetërore dhe Lokale

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë , Drejtoritë tjera, sektori privat dhe OJQ-të do të marrin pjesë në programet e trajnimit shtetëror sipas programeve dhe kalendarit të caktuar.

VII. KËRKESAT PËR PLAN, MIRËMBAJTJA DHE SHPËRNDARJA

A. Përgjegjësitë e Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë: QOE komunale, është përgjegjësi e zyrtarëve të zgjedhur, por zakonisht QOE do të koordinojë në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e planit. Komponentet e Planit do të shqyrtohen dhe të freskohen nga KME çdo dy vjet ose sipas nevojës. Disa anekse të incidenteve specifike kërkojnë një rishikim vjetor, në bazë të legjislacionit apo rregulloreve. Kurdo që, pjesët e këtij plani zbatohen, në një rast Emergjent ose ushtrim, duhet të kryhet një shqyrtim për të përcaktuar ndryshimet e nevojshme.

B. Detyrueshmëria:

Ky plan është i zbatueshëm dhe i aprovuar në bazë të dispozitave të AME-së por jo edhe i detyrueshëm.

C. Zbatimi:

Ky plan do të zbatohet me urdhër të **Kryetarit të Komunës** ose të përfaqësuesit të autorizuar të nga ai dhe Koordinatorit Komunal të Menaxhimit Emergjent.

D. Shpërndarja

Ky plan dhe materialet tjera mbështetëse të tij, janë dokumente të kontrolluara. Ndërsa shpërndarja e "Planit Bazik" është e lejueshme, ai përmban: listat kontrolluese, Njoftimet dhe Doracakun e Resurseve, dhe disa Plane të Incidenteve Specifike që përmbajnë përgjigje specifike ose informacione personale dhe nuk konsiderohen të jenë në dispozicion të publikut. Shpërndarja bazohet në rregullore ose funksione (veprime) "duhet të dini" Kopjet e këtij plani, janë shpërndarë në bazë të një liste, të kontrollit të miratuar. Një rexhistër i shpërndarjes, me numrin e kopjes, mbahet në dosje nga KME. Kopjet e kontrolluara dhe të rshikuara do të shpërndahen për të përcaktuar mbajtësit e planit. Rishikimet apo ndryshimet janë të dokumentuara me anë të skemës "Regjistroni Ndryshimet". Një sistem vërtetimi (marrje) do të përdoret për të verifikuar këtë proces.

Shtojca 1 – Fjalori i Termeve Kryesore**Kryqi i Kuq i Kosovës**

Organizat humanitare e udhëhequr nga vullnetarët, të cilët ofrojnë ndihma për viktimat e fatkeqësisë dhe ndihmojnë në parandalimin, përgatitjen dhe reagimin ndaj emergjencave. Këtë e bënë përmes shërbimeve të cilat janë në përputhje me ligjin dhe Parimet e Lëvizjes së Kryqit të Kuq ndërkombëtar.

Spektori i Komandës

Një nga pesë fushat funksionale të Sistemit të Komandës së Incidentit. Funksioni i komandës është të drejtoj, kontrolloj, apo urdhëroj resurset, përfshirë njerëzit dhe pajisjet, për të mirën më të madhe të mundshme.

Post Komanda

Lokacion në të cilin zbatohen funksionet parësore të Komandës; zakonisht të bashkvendosura me Bazën e Incidentit. E referuar tek ne, gjithashtu edhe si Post komanda e Incidentit.

Menaxhimi Gjithpërfshirës i Resurseve

Maksimalizon shfrytëzimin e resurseve të disponueshme, konsolidon resurset e përafërta dhe zvogëlon mbingarkesën në komunikim në Operacionet e Komandës së Incidentit.

Koordinimi

Proces i analizimit sistematik të situatës, ndërtimit të informacioneve relevante dhe informimit të personelit përkatës lidhur me alternativat e mundshme për përzgjedhjen e kombinimit sa më efektiv të resurseve të disponueshme për arritjen e objektivave të caktuara.

Emergjenca

Çdo ndodhi, apo kërcënim, çoftë natyrore apo e shkaktuar nga faktori njeri, e cila rezulton apo mund të rezultoj në lëndime apo dëmtime substanciale në popullat apo dëme ose humbje substanciale e të mirave materiale apo resurseve natyrore dhe që mund të përfshij veprim qeveritar përtej asaj të autorizuar me ligjin ekzistues.

Dekontaminimi

Proces i sigurimit të njerëzve, objekteve dhe zonave nëpërmjet absorbimit, neutralizimit, zvogëlimit të efektit dëmtues apo zhvendosjes së Materieve të Rrezikshme

Emergjencë/Fatkeqësi/Incident

Një ngjarje e cila kërkon reagim kulmor përtej fushveprimit të çdo agjencie apo shërbimi të vetëm dhe që paraqet rrezik për komunitetin apo hapësirën më të gjerë. Një emergjencë është zakonisht një ngjarje e cila mund të kontrollohet brenda fushëveprimit të kapaciteteve lokale; emergjenca e madhe apo fatkeqësia zakonisht kërkon përtej asaj që është e disponueshme në nivel lokal.

Sistemi i Alarmimit Emergjent

Rrjet i stacioneve të shpërndarjes që ndëlidh objektet e autorizuara nga Komisioni Qendror për Komunikim për të operuar në mënyrë të kontrolluar për alarmimin dhe informimin e publikut për veprimet e nevojshme mbrojtëse në raste të fatkeqësive apo situatave emergjente.

Qendra e Operative Emergjente Lokale

Objekt nga ku Ekzekutivi komunal , drejton dhe kontrollon operacionet e saj emergjente, ku në këtë objekt apo zyre ku informacionet grumbullohen lidhur me gjendjen e situatës emergjente, analizohen, kontrollohen dhe pastaj raportohen zyrtarisht, ku bëhet koordinimi midis sektoreve dhe Funksioneve mbështetëse (**FME-ve**) dhe nga ku kërkohet zyrtarisht asistenca nga jashtë, nese nuk mund të menaxhohet ngjarja nga resurset dhe kapacitetet lokale.

Plani i Reagimit Emergjent

Dokument i cili ofron një reagim të paraplanifikuar dhe koordinuar në rast të një situatë emergjente apo fatkeqësie.

Menaxhimi Emergjent

Përgatitja për funksionet dhe bartja e tyre (tjetër nga funksionet për cilat parësisht përgjegjëse janë forcat ushtarake) për të parandaluar, zvogëluar dhe sanuar lëndimet dhe dëmet që rezultojnë nga fatkeqësitë natyrore apo të shkaktuara nga faktori njeri. Këto funksione përfshijnë zjarrfikjen, policinë, shëndetin dhe mjekësinë, shpëtimin, paralajmërimin, ingjinerinë, komunikimin, evakuimin, menaxhimin e resurseve, mbrojtjen e bimëve, restaurimin e shërbimeve publike dhe funksionet tjera të lidhura me ruajtjen e sigurisë, shëndetit dhe mirëqenjes së popullatës.

Funksioni i Mbështetjes Emergjente

Fushë funksionale e aktivitetit reagues e themeluar për lehtësimin e shpërndarjes së asistencës qendrore të nevojshme gjatë fazës së reagimit të menjëhershëm në fatkeqësi për shpëtimin e jetëve, mbrojtjen e të mirave materiale dhe shëndetit publik dhe mirëmbajtjes së sigurisë publike.

Ushtrim

Një aktivitet i destinuar për përkrahjen e gatishmërisë emergjente; testimin apo vlerësimin e planeve të operacioneve emergjente, procedurave apo shërbimeve; trajnimin e personelit në detyrat e reagimit emergjent dhe demonstrimin e kapacitetit operacional. Ekzistojnë tri lloje të caktuara të ushtrimeve: në tavolinë, funksional dhe shkallë të gjerël.

Evakuimi

Të ndihmuarit e njerëzve për të lëvizur nga pragu apo rreziku i fatkeqësisë në një zonë të sigurisë relative.

Sistemi Informativ Gjeografik

Sistem kompjuterik i aftë për grumbullimin, sortimin, manipulimin dhe pasqyrimin e informacioneve të referuara gjeografike, si psh. të dhënat e përcaktuara sipas lokacionit të tyre.

Materiet e Rrezikshme

Janë substanca apo materie të cilat mund të shkaktojnë rrezik të pa pa pashikueshëm për shëndetin, pasurinë, ose për ambientin, kur përdorën, transportohen, ruhen, ose tjetërsohen. Këtu mund të përfshihen materiet që janë të ngurta, të lëngshme ose në gjendje të gaztë. Gjithashtu materiet e rrezikshme mund

të përfshijnë substanca toksike, djegëse dhe irrituese, eksploziv ose materie gërryese, si dhe dhe materie radioaktive.

Sistemi i Komandës së Incidentit

Model për reagim ndaj fatkeqësisë i cili përdor terminologji të zakonshme, organizim të përshtatshëm, komunikim të integruar, strukturë komanduese të unifikuar, planifikim të veprimeve, hark kontrolli të menaxhueshëm, objekte të para-caktuara dhe menaxhim gjithpërfshirës të resurseve. Në SKI ekzistojnë pesë elemente funksionale: **Komanda, Operacionet, Logjistika, Planifikimi dhe Financat/Administrata.**

Komandanti i Incidentit

Person përgjegjës për menaxhimin e të gjitha operacioneve të incidentit.

Raporti i Vlerësimit të Dëmeve Fillestsare

Raport i cili ofron informacione lidhur me dëmet e përgjithshme ndaj pronave publike dhe private dhe në këtë mënyrë ofron bazën për shpalljen e gjendjes emergjente apo nevojës për asistencë.

Plani i Komunikimit të Integruar

Ky plan koordinon përdorimin e mjeteve të disponueshme të komunikimit dhe cakton frekuencat për funksionet e caktuara.

Emergjencë Lokale

Gjendje e shpallur nga trupi qeveritar lokal kur, sipas gjykimit të këtij trupi, ndodhja apo rreziku nga ndodhja e fatkeqësisë është apo kërcënon të jetë e përmasave dhe ashpërsisë së atillë, e cila kërkon veprim të koordinuar të qeverisë lokale për të parandaluar apo zbutur humbjen e jetëve, dëmtimin e pronave apo varfërimin. Vetëm Kryetari i Komunës, me kërkesë të trupit qeveritar, mund ta shpall gjendjen emergjente.

Lehtësimi/Zbutja

Aktivitete të cilat faktikisht eliminojnë apo zvogëlojnë gjasat e ndodhjes apo efekteve të një fatkeqësie. Në shembujtë e masave lehtësuese/zbutëse përfshihen (por nuk kufizohen me kaq), punimi i ligjeve apo rregulloreve për shfrytëzimin e tokav, përforcimi i standardeve të ndërtimit, rregulloreve dhe licencave për prodhimin, përdorimin dhe deponimin e materieve të rrezikshme dhe inspektimi dhe zbatimi i këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

Marrveshje për Ndhimë Reciproke

Marrveshje me shkrim midis agjencive dhe/apo juridiksioneve në të cilën ata pajtohen ta ndihmojnë njëri tjetrin, me kërkesë, duke dërguar personel dhe/apo pajisje në një situatë emergjente.

Shërbimi Meteorologjik Kombëtar

Agjenci qendrore e cila ofron për popullatën informacione lidhur me motin dhe gjatë emergjencave të lidhura me motin, për zyrtarët shtetëror dhe lokal të menaxhimit emergjent.

Gatishmëria

Hartimi i planeve për të siguruar reagim sa më efikas dhe efektiv ndaj një fatkeqësie apo emergjence. Aktivitetet e gatishmërisë janë të destinuara për të ndihmuar shpëtimin e jetëve dhe zvogëlimin e dëmeve duke i përgatitur njerëzit të reagojnë si duhet kur një emergjencë është e pashmangshme. Gatishmëria gjithashtu përfshinë trajnimet, ushtrimet dhe ngritjen e resurseve të domosdoshme për arritjen e gatishmërisë për të gjitha rreziqet.

Shpallja Presidenciale

Shpallja presidenciale liron burimet e ndryshme të asistencës nga Qeveria Qendrore bazuar në natyrën e kërkesës nga Kryetari i Komunës.

Agjencia Parësore

Për derisa një numër i agjencive lokale do të performojnë një numër të detyrave të ndryshme gjatë fatkeqësisë, në shumicën e rasteve vetëm një prej tyre do të jetë "Agjenci Parësore". Agjencitë parësore do të jenë përgjegjëse për planifikimin e hollësishëm, testimin dhe vlerësimin e funksioneve të tyre përkatëse të mbështetjes emergjente. Drejtori i agjencisë parësore do të shërbej si këshilltar kryesor për Kryetarin e Komunës gjatë fazës së reagimit dhe rimëkëmbjes. Për më tepër Drejtori i agjencisë parësore duhet të siguroj që operacionet esenciale të agjencisë së tij do të vazhdojnë, përveç nëse ndryshe vendoset nga Kryetari i Komunës apo i caktuari i tij.

Qendra Rajonale për Koordinimin e Informacioneve

Qendra lehtëson komunikimin dhe koordinimin midis autoriteteve lokale, rajonale dhe qendrore për të siguruar një reagim efektiv dhe koherent ndaj emergjencave dhe incidenteve rajonale.

Raport Situate

Raport i cili plotësohet në fund të çdo dite operative të qendrës operative emergjente lokale dhe i cili e pajis rajonin me një përmbledhje zyrtare të gjendjes së emergjencës dhe reagimit emergjent lokal. Kopja e raportit duhet të dorëzohet tek QOE Rajonale përmes faksit apo në Departamentin e Menaxhimit Emergjent përmes vebfaqes së tij.

Harku i Kontrollit

Harku i kontrollit është numri i vartësve të cilët mund t'i mbikëqyr në mënyrë efektive një mbikëqyrës. Udhëzimet për një hark të dëshirueshëm të kontrollit rekomandojnë tre deri në shtatë persona. Numri optimal i vartësve është pesë për një mbikëqyrës.

Gjendja Emergjente

Gjendje e shpallur nga Presidenti kur, sipas gjykimit të tij, një fatkeqësi aktuale apo kërcënuese në çdo pjesë të shtetit është i përmasave dhe ashpërsisë së atillë e cila kërkon asistencë nga shteti për plotësimin e përpjekjeve lokale për parandalimin apo lehtësimin e humbjeve në jetë dhe dëmeve në pronë.

Komanda e Bashkuar

Përgjegjësi e ndar për menaxhimin e përgjithshëm të incidentit si rezultat i incidentit shumë-juridiksional apo shumë-agjencor. Në rastet e prioriteteve dhe qëllimeve kontradiktore, apo ku resurset janë të pakta, duhet të ketë linjë të qartë të autoritetit për vendimmarrje. Agjencitë kontribuojnë në komandën e bashkuar duke përcaktuar qëllime dhe objektiva të përgjithshme, duke planifikuar së bashku aktivitetet taktike, duke kryer operacione të integruara taktike dhe duke ngritë në maksimum shfrytëzimin e të gjitha resurseve të caktuara me detyrë.

Shtojca 2 – Lista e Shkurtesave

SHISHKB	Shërbimi i Inspektimit të Shëndetit të Kafshëve dhe Bimëve
IKSHPK	Instituti Komëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
EKRE	Ekipet e Komunitetit për Reagim Emergjent
ZKF	Zyrtari kryesor Financiar
MK	Marrëdhëniet me Komunitetin
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
QRF	Qendra për Rimëkëmbje nga Fatkeqësia
ME	Ministria e Ekonomisë
MRF	Menaxheri për Rimëkëmbje nga Fatkeqësia
SAE	Sistemi i Alarmimit Emergjent
QOEL	Qendra Operative Emergjente Lokale
FME	Funksion Mbështetës Emergjent
AMA	Agjencioni për Mbrojtjen e Ambientit
ERE-A	Ekipi i Reagimit Emergjent – Elementi Avancues
AME	Agjencioni Qendror i Menaxhimit Emergjent
SKI	Sistemi i Komandës së Incidentit
QBI	Qendra e Bashkuar Informative
ZBF	Zyra e Bashkuar Fushore
MACC	Qendra për Koordinim të Shum-Agjencive
MiM	Memorandum i Marrëveshjes
MeM	Marrëveshje e Mirëkuptimit
SKP	Sistemi Kombëtar i Paralajmërimit
OJQ	Organizatë Jo Qeveritare
SKMI	Sistemi Kombëtar i Menaxhimit të Incidenteve
PRK	Plani i Reagimit Kombëtar

SHMK	Shërbimi Meteorologjik Kombëtar
VPD	Vlerësimi Preliminar i Dëmeve
ZIP	Zyrtari për Informim Publik
PeK	Pik e Kontaktit
KSH	Kërkimi dhe Shpëtimi
PSO	Procedurat Standarde Operative
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
OVAF	Organizatat Vullnetare Aktive në Fatkeqësi
ASHM	Armët e Shkatërrimit në Masë

Shtojca 3 – Autoriteti dhe Referencat

Qendror

1. Ligji mbi Këshillin e Sigurisë së Kosovës
2. Ligji për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera
3. Sistemi Kombëtar i Menaxhimit të Incidenteve.

Rajonal

1. Ligji për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera
2. Plani Operativ Emergjent Rajonal

Lokal

1. **Plani i Vlerësimit të Rreziqeve**
2. **Plani i Reagimit në nivel Lokal**

✓Ligji për fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera/2006/2012

✓Ligji për Mbrojtjen nga zjarri/2006/2011

✓Udhëzimi administrative XIX/2008●

✓Vlersimi I rreziqeve, niveli Qendror dhe Lokal-2025

✓Sistemi Kombëtar i Menaxhimit Emergjent. SIME 2010

Shtojca 4 – Matrica e përgjegjësiave

Agjencia	FME # 1 Transporti	FME # 2 Komunikimi	FME # 3 Punët Publike	FME #4 Zjarrfikja	FME #5 Menaxhimi	FME #6 Kujdesi masiv	FME #7 Mbështetja e Resurseve	FME #8 Shëndeti dhe Mjekësia	FME #Kërkimi dhe Shpëtimi	FME #10 Materiet e Rrezikshme	FME #11 Resurset Bujqësore dhe Natyrore	FME #12 Energjia	FME # 13 Siguria Publike	FME #14 Rimëkëmbja Afat-Gjate	FM #15 Marrëdhëniet me Jashtë
Menaxhimi Emergjent	●														
Zjarrfikja				●											
Shërbimi Emergjent Mjekësor								●							
Zbatimi I Ligjit													●		
Punët Publike			●												
Planifikimi Hapësinor													●		
Komun	●	●	●	●	●	●	●	●	●	●	●		●	●	●

Kryqi i Kuq						•			•				•	
Teknologjia Informative	•													
Shërbimet Sociale													•	
Financat													•	
Transporti	•													
Shkollat publike						•								
Bordi i Shërbimeve të Komunitetit		•												
Autoriteti i Ujërave										•				
Prokurori Publik në nivelin Lokal												•		
Marrëdhënie t me Publikun		•												
OVAF														
Task Forca Lokale për Rimëkëmbje													•	

Shtojca 5 – bartja e Autoritetit

Vijimësia e Qeverisjes është kritike për zbatimin e suksesshëm të operacioneve emergjente. Prandaj, në parashikim të çdo eventualiteti që mund të rezultoj në mospraninë e pjesëtarit të ranguar të hierarkisë administrative, janë paraparë linjat në vijim të bartjes së autoritetit. Autoriteti i vendimmarrjes për çdo organizatë apo shërbim është renditur më posht sipas pozitive nga e larta tek më e ulta.

Organizata/funksioni Shërbyes

Bordi i Drejtorëve të Komunës

1. Kryetari i Komunës,
2. Nënkryetari i komunës,
3. Shefi i kabinetit të kryetarit,
4. Drejtori i Drejtorisë për Shendetësi dhe Mirëqenje Sociale,
5. Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë,
6. Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
7. Drejtori i Drejtorisë për Administratë,
8. Drejtori i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik,
9. Drejtori i Drejtorisë për Buqësi dhe Zhvillim rural,
10. Drejtori i Drejtorisë për Infrastruktur lokale,
11. Drejtori i Drejtorisë për Urbanizmen dhe Mbrojtje të Mjedisit,
12. Drejtori i Drejtorisë për Kulturë , Rini dhe Sport,
13. Drejtori i Drejtorisë për Gjeodozi, kataster dhe Pronë,
14. Drejtori i Drejtorisë për Inspeksion,
15. Drejtori i Drejtorisë për Arsim,

Qendra e Menaxhimit Emergjent Lokal

1. Komiteti për Mbrojtje dhe Shpetim(kryetari i komunes dhe anëtarët e BoD) ,
2. Komandanti i Stacionit të Policisë i Komunës së Gllogocit,
3. Koordinator i Menaxhimit Emergjentë,
4. Komandanti i Incidentit(sipas nevojës),
5. Kryesuesit e ekipeve emergjente(1-Mjeksore, 1-Zjarri-fësve, 1-evakuimit, 1-kryqi kyq, etje).
6. Përfqësuesit e FSK-së,(sipas nevojës),
7. Zyrtari për Informim.

Shtojca 6 – Lista e Shpërndarjes së PREL

Drejtori i menaxhimit Emergjent;

Koordinatori i Menaxhimit Emergjent;

Zyra e komandantit të Stacionit Policor;

Shërbimi i Zjarri-fësjes;

Shërbimet komunale (rrymë,Ujë , mbeturina);

Drejtori i Inspektorëve;

Drejtori i Urbanizimit dhe planifikimit hapsinor;

Drejtori i Shërbimeve Sociale;

Administratoret e fshatrave dhe qytetit;

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;

Prokurori i në nivel komunal;

Qendra e Kumunikimit ;

Bordi i Drejtorëve

Drejtoria komunale të Arsimit

Zyra për Informim me Publikun, në nivel komunal

Skuadrat e Shpëtimit

Ekipi për vlerësimin e Dëmeve

Sektorit të Transportit

Drejtoria për infrastrukturë lokale

Shtojca 7 – Dokumentet Esenciale

Shënimet Gjyqësore

Ruajtja e shënimeve esenciale për lokalitetin është përgjegjësi e Sekretarit të Gjykatës së në nivel komunal. Të gjitha shënimet esenciale duhet të ruhen në dosje, të vendosura në Zyrën e Sekretarit të Gjykatës së komunale. Në këto shënime përfshihen me sa vijon:

Dokumentacioni i Pasurive të Patundshme;

Të dhënat Kriminale;

Testamentet ;

Regjistrat Civil;

Dokumentacioni i Gjykatave Civile;

Certifikatat e Martesave;

Evakuimi i dokumenteve në raste të një emergjence do të bëhet vetëm me miratimin e Sekretarit të Gjykatës së Qarkut.

Ngarkimi dhe transporti i këtyre dokumenteve është përgjegjësi e Departamentit të Policisë.

*** Një kopje e mikrofilmit/diskut me të dhënat e patundshmërisë për lokalitetin, duhet të ruhet në Arkiva të sigurtë.**

Agjencionet/Organizatat

Çdo agjenci/organizatë brenda strukturës së pushtetit lokal duhet të themeloj programin për mbrojtjen e dokumenteve/të dhënave të veta. Dokumentet e caktuara si esenciale për vijimin e funksioneve qeverisëse duhet të identifikohen dhe vendosen procedura për mbrojtjen e tyre, siç janë dyfishimi i kopjeve në një vend tjetër dhe/apo përdorimi i objekteve të sigurta për deponim të dokumenteve. Duhet të merren masa për operim të vazhdueshëm të sistemit të përpunimit automatik të të dhënave.

Shtojca 8 – Shembull i vendimit të SIME

Deklarat e Miratimit

Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave është miratuar nga MPB të Republikës së Kosovës si në vijim:

DUKE PATUR PARASYSH QË, me kërkesën e kryeministrit, ministria e Punëve të Brendshme ka ndërtuar Sistemin e Integruar të Menaxhimit të Emergjencave (SIME) me qëllim të unifikimit dhe koordinimit të të gjithë përpjekjeve të reaguesve emergjent gjatë fatkeqësive; dhe

DUKE PATUR PARASYSH QË, Ministria e Punëve të Brendshme ka udhëzuar të gjitha entitetet qendrore, rajonale dhe lokale të përfshira në reagimin emergjent për ta adaptuar SKMI; dhe

DUKE PATUR PARASYSH QË Kryeministri ka futë në fuqi SIME-n duke e shpallur atë si bazament zyrtar për menaxhimin e reagimit ndaj incidenteve në vend; dhe

DUKE PATUR PARASYSH QË, SIME do t'i mundësoj reaguesve në të gjitha nivelet për të punuar së bashku në mënyrë më efikase dhe efektive për menaxhimin e incidenteve vendore pavarësisht shkakun e tyre, madhësinë apo kompleksitetin, përfshirë aktet katastrofale të terrorizmit dhe fatkeqësitë natyrore; dhe

DUKE PATUR PARASYSH QË, Agjencia e Menaxhimit Emergjent aktualisht e udhëzon për përdorimin e Sistemit të Komandës së Incidentit (SKI) i cili i referohet SIME-s; dhe

DUKE PATUR PARASYSH QË, Komuna e Glogocit e njeh nevojën e përdorimit të një sistemi të vetëm të menaxhimit të emergjencave nga agjencitë dhe disiplinat lokale;

VENDOS, që komuna e Glogocit pranon SIME-n, dhe se ky sistem do të përdoret në të gjitha incidentet dhe stërvitjet, mësohet në të gjitha kurset trajnuese të institucioneve lokale dhe reflekton në të gjitha programet e drejtorive komunale dhe AME-së në lëmin e parandalimit, gatishmërisë, reagimit dhe rimëkëmbjes.

Kryesuesi,

Shtojca 9 – Shembull i Vendimit për Aprovimin e POE

VENDIM

PLANI REAGIMIT EMERGJENT

DUKE PAS PARASYSH QË: Asambleja Komunale dhe Kryetari i Komunës së Gllogocit njohin nevojën për tu përgatitur, reaguar dhe rimëkëmbur nga fatkeqësitë natyrore dhe ato nga faktori njeri;

DUKE PAS PARASYSH QË: Kryetari i Komunës ka përgjegjësi për siguri dhe mirëqenje të qytetarëve dhe vizitorëve të tij; dhe

DUKE PAS PARASYSH QË: **Kryetari** ka vendosur dhe caktuar Drejtor dhe Koordinator të Menaxhimit Emergjent komunal; kështu që

Pas shqyrtimit të Planit Operativ Emergjent, Kryetari i Komunës së Gllogocit dhe Asambleja komunale, VENDOSIN që ky PRE është miratuar zyrtarisht; dhe

ËSHTË VENDOSUR DHE URDHËRUAR që Drejtori i për Shërbime Publike dhe Emergjencë, apo i emëruari i tij/saj, janë caktuar me detyrë dhe autorizuar ta mbajnë dhe rishikojnë/ripunojnë sipas nevojës këtë dokument, gjatë periudhës dy , tr apo katër vjeqare, apo derisa të urdhërohet ndryshe nga ky bord.

Kryetari i Komunës:

VËRTETON:

Kryesuesi i kuvendit

Ky Plan Operativ Emergjent Miratohet me datën _____ 2025

Shtojca 10 – Shembull i Shpalljes së kërkesë për shpalljen e Gjendjes Emergjente Lokale

DUKE PAS PARASYSH QË, Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë i Komunës së Gllogocit ka konstatuar që:

1. Për shkak të _____ (Thekso Ngjarjen) _____, Komuna po ballafaqohet me rrethana të rrezikshme;

2. Për shkak të _____ (Thekso Ngjarjen) _____, të gjendjes me rrezikshmëri të jashtzakonshme për jetën dhe pronat e bënë të domosdoshme kërkesën për shpalljen e gjendjes së jashtzakonshme lokale;

PRANDAJ, NË KËTË MËNYRË DEKLAROJMË që në Komunën e Gllogocit ekziston/apo ka ekzistuar emergjenca; dhe

ËSHTË SHPALLUR DHE URDHËROHET që gjatë emergjencës së lartpërmendur, fuqitë, funksionet dhe detyrat e organizatës së menaxhimit Emergjent të Komunës do të jenë/janë ato të përcaktuara me Ligjin, dhe Dekretet, Vendimet dhe planet e miratuara nga Komuna me qëllim të zbutjes së efekteve të emergjencës së lartpërmendur.

Data

Kryetari i Komunës

Komuna e Gllogocit

SHTOJCAT:

Plani i reagimit emergjentë për Zjarre fushore – Malore, objekte banimi, objekte industriale dhe prodhuese, pomapa të derivateve, aksidente rrugore etj.

Qëllimi i hartimit të këtij Plani është :

- **Parandalimi i dëmeve që shkatohen nga zjarret, aksidentet etj;**
- **Mbrojtja e jetës se njerëzve, pronës dhe infrastrukturës;**
- **Përcaktimi i veprimeve dhe përgjegjësi në rast të këtyre ngjarjeve;**

Andaj duke u bazuar në Planin e Vlerësimit të Rrezikut, zjarret fushore-malore, zjarret në objekte banimi, objekte industriale dhe prodhuese, në objekte të pompave të derivateve të naftës e tj, që paraqesin rrezik për jetët e njerëve, shkatërrimit të pasurisë, po ashtu edhe dëmeve të tjera. Sipas statistikave të marrura nga data baza e NJPSHZSH , prej viteve 2014 -2025 kemi pasur **1193** zjarre Fushore , **332** zjarre Malore dhe me një dëmtim të pyjeve rrethë 456.41 Ha, ndërsa në objekte banimi kemi pasur me shumë se **210** intervenime, në objekte industriale me shumë se **5** raste, të cilat kanë qenë më intenzitet të lartë dhe me pasoja dhe dëm të mëdha në pajisje dhe objekte, ndërsa tek pompat e derivateve për fat nuk kemi pasur zjarre që kanë lënë pasoja , pos disa rasteve që janë intervenuar për parandalim të tyre, pastaj kemi raste edhe për intervenime nga Aksidentet rrugore, etj, prandaj si rezultat i këtyre, është e nevojshme edhe hartimi i Planit të reagimit për këto raste.

Aktivizimi i Planit të Reagimit Emergjent bëhet me marrjen e alarmit për emergjencë nga Zyra për alarmim 112, nga Policia e Kosovës apo edhe individ tjerë.

Aktivizimi i Njësisë Profesionale Shërbimit të Zjarrfikëseve dhe Shpëtim (NJPSHZSH), bëhet pas marrjes së informacionit për mundësi të ndodhjes së ngjarjes , andaj reagimi emergjentë kalon nëpër këto etapa:

- **Etapë 1:** “Alarm për rritjen e gatishmërisë” është tërësia e masave për njoftimin paraprak pas marrjes së informacionit se mund të lindë një situatë emergjente si zjarri dhe shërben si sinjal për rritjen e gatishmërisë;
- **Etapë 2:** “Gatishmëria” është tërësia e masave për njoftimin paraprak, pasues, pas informacionit që një situatë emergjente që zjarri është e afërt ose në zhvillim, apo për intervenim në aksidente rrugore;
- **Etapë 3:** “Aktivizimi” është kur një situatë emergjente ngjarja ka ndodhur realisht;
- **Etapë 4:** “Dalja nga situata” është mbyllja e fazës së aktivizimit, pavarësisht sesa etapa të mëparshme kanë ndodhur realisht.

Sipas situatave, mundë të mos kalohet në të gjitha etapat. Në rastin e një ngjarjeje të papritur, të menjëhershme, aktivizimi i sistemit fillon drejtpërdrejt me etapën 3 “aktivizimin”.

Etapë 1: “Alarm për rritjen e gatishmërisë”

Drejtori i DSHPE-së ose shefi i NJPSHZSH vendos fillimin e etapës 1, “alarm për rritjen e gatishmërisë”, në çastin e marrjes së informacionit për mundësinë e ndodhjes së një **NGJARJE** i cila mund të shoqërohet me dëmtime në njerëz dhe dëme materiale.

Etapë 2: Vendosja e Gjendjes së Gatishmërisë

Drejtori i DSHPE-së, vlerëson nevojën e fillimit të **Etapës 2**, “vendosjes së gjendjes së gatishmërisë”. Kjo bëhet kur një ngjarje e afërt konsiderohet e pashmangshme dhe që mund të shoqërohet me dëme në njerëz dhe të mira materiale.

Etapë 3: Aktivizimi

Fillon në rastet kur një ngjarje e papritur ka shkaktuar dëmtime materiale ose edhe në njerëz.

Etapë 4: Dalja nga Situata

Njoftimi për **Etapën 4**, “daljen nga situata”, bëhet nga i njëjti autoritet që e ka urdhëruar fillimin e etapës 1, 2 ose 3.

Etapë 4, “dalja nga situata”, paraqet situatën normale në vend, kur nuk ekziston kërcënim i drejtpërdrejtë pas intervenimit të kryer.

Në çdo rast dalja nga situata bëhet kur:

- Është bërë vlerësimi i plotë i situatës.
- Kërcënimi i fatkeqësisë është zvogëluar apo eliminuar.

- *Operacionet e ndihmës kanë dhënë rezultatet e duhura.*
- *Nevojat më të nevojshme janë plotësuar.*

VEPRIMET PËR INTERVENIME EMERGJENTE

Njësia e zjarrfikësve duke kaluar nga fazat :1-2-3-4,varësisht nga intensiteti i ngjarjes , bënë përgaditjen e pajisjeve dhe mjeteve adekuate për shuarje të zjarreve fushore dhe malore, ndërsa për intervenime në ngjarje të tjera , përgaditet, me automjetet dhe pajisje të nevojshme, sipas llojit të ngjarjes, duke njoftuar Drejtorin e DSHPE-së, dhe vazhdojnë në lokacionet që është marr informata.

Operacionet themelore i kryejnë njësitet e përbëra nga zjarrfikësit, Automjetit, udhëheqësi i ekipit + shoferi + çifti.

ROLI DHE FUNKSIONI

Ekipi sulmues:

Në rast të zjarreve, zjarrfikësit janë përgjegjës për shuarje të zjarreve duke e drejtuar hedhësen e ujit në drejtim të vatres së zjarrit, në aksidente, duhet bërë debllikimin e automjetit për nxjerrjen e personave të lënduar apo atyre me pasoja fatale, dhënjën e ndihmës së parë (nga ekipi i zjarrfikësve apo ekipi mjeksor që është i trajnuar për intervenime medikale).

Në objektet: E banimit, industriale, apo të derivative të naftës ku krijohet tym i madhë, çdo ekip i sulmit duhet të pajiset me aparat të frymëmarrjes, nëse nuk urdhërohet ndryshe, dhe pajisje të tjera të nevojshme, dhe fillimisht fillon e evakuimit e stafit/ banoret/ nga ndërtesa/lokalit/ objekti industrial/ dhe njëkohësisht edhe reagimi në shuarje të zjarrit.

Ekipi furnizues:

Ka për detyrë të furnizoj me ujë ekipin sulmues, duke e shtri gypin e mbështjell në makare, në rast të zjarreve, duke qantat shpinore apo ajrfryerësit portativ tek zjarret fushore dhe malore, ndërsa për aksidente, duhet të që ekipi furnizues të furnizoj me pajisje të tjera (Gërsherë hidraulike, fleks, presa hidraulike dhe pajisje të tjera), kurse tek rastet e zjarreve në objektet e derivative të naftës të bëjë furnizimin me shkumë, boca të mbyshur me pluhur , boca të mbushur me CO₂, ujë etj).

Kjo nuk është detyra e vetme e këtij e ekipit furnizues, por sipas nevojës së ngjarjes/aksidentit/. Pas përgaditjes së pajisjeve mundë të bashkangjitet ekipi sulmues ose të kryej detyrë tjetër sipas urdhërësës së Komandanit të Incidentit/ekipit.

FAZA E PËREGADITJES

Identifikohet vendi dhe lloji i ngjarjes, pastaj caktohen lloji i pajisjeve dhe lloji i automjeteve.

Furnizimi me ujë dhe pajisje të tjera të nevojshme:

Shefit të ekipit i takon që të zgjedhë pikën më të përshtatshme për furnizim me ujë, në rast të zjarrit, ndërsa për aksidente në komunikacion rrugor të përdor automjetin teknik dhe pajisjet e nevojshme për deblokim të personave të ngjuar në automjetin e aksidentuar, dhe dhënja e ndihmës së parë, nga ekipi i zjarrfikësve të cilët kanë kryer trajnimet për intervenime medikale në aksidente në komunikacion rrugor.

Pajisjet themelore:

Pajisjet themelore që janë të disponim të NJPSHZSH-së, në komunën e Glllogocit janë dhënë në tabelën në vijim:

Lista e resurseve materiale teknike

Resurset materiale: pajimet dhe pajisjet zjarrfikëse	Automjetet e NJPSHZSH-së	Nr .Sasia	Kapaciteti
	Automjet Komandues	1	3.4m ³
	Automjet Sulmues	1	4560 lit.
	Automjet Furnizues (Auto Cisternë)	0	0
	Automjet Teknik	2	Pajisje për shpëtim
	Automjet me shkall hidraulike	0	0
	Automjet fushor-malor	1	800 lit.
	Automjet tjetër	0	0
	Gjenerator	3	(12-5-3)kë
	Pompë uji	3	Ø 110,Ø75,Ø52
	Barkë për shpëtim në ujë	0	0
	Pajisje për zhytje	0	0

Pajisjet kolektive				Sasia	Kapaciteti
Resurset materiale: pajimet dhe pajisjet zjarrfikëse	Radiolidhje dore Kenëood			12	
	Radiolidhje Statike			2	
	Aparat të frymëmarrjes			5	Auer-Drager
	Maska për frymëmarrje të thjeshta			6	
	Presa hidraulike			2	
	Hapsa hidraulike			3	
	Sëpatë			2	
	Jeleva shpetues për ujë			10	
	Litar shpetues			10	25 M
	Shkallë levizëse alumini (palë)			2	3 palshe
	Shkallë litarë			1	3.5 M
	Tuba (Gypa)		Ø 110	10	15 M
			Ø 75	30	15 M
			Ø 52	25	15 M
	Shprendarësa të ujit		Tre kokësh	5	
			Dy kokësh	3	
Dyshek për kërcim			0		
Leshues për shpetim-Reglis			3		
	Hidrantët në qytet			Në objektet me rëndësi të veçant	
				Në stacionin e Zjarrfikësve	
				Në oborrin e Komunës	
Burimet alternative për furnizim me ujë, resurse të pa levizëshme				Pishina „ZHIRON” Korroticë e Ultë	
				Lumi Drenica-Drenas	
				Bazenat e Feronikelit- Qikatovë e Vjetër	

Pra , NJPSHZSH-së, sipas nevojës, i përdorë këto automjete dhe pajisje: Për rastet e zjarreve Malore , zakonisht e përdorin Automjetin Fushoro-malore me kapacitet deri ne 800 l, në rastet e zjarreve Malore, ndërsa në zjarret fushore e përdorin automjetin sulmues me kapacitete deri ne 4500 l. Po ashtu për tërene të vështira malore i përdorin edhe qantat shpinore dhe ajrfryerëset portative.

Siapas nevojës dhe llojit të ngjarjës, intervenon e edhe ekipi mjekësor, sidomos në rastet e aksidenteve rrugore, dhe rasteve të tjera ku kërkohet ndihma dhe ndërhyrja e tyre.

Pajisjet themelore që Ekipa emergjente e Komunës se Gllogocit i ka në disponim për intervenime emergjente mjeksore, janë paraqitur në tabelen në vijim.

Resurset materiale: Automjetet dhe pajisjet për ekipen mjeksore emergjente	Automjetet dhe pajisjet e Ekipës Emergjente në kuadër të DSHMS/QKMF-së		Sasia
	Automjet Autoambulancë komplet me pajisje	6	
	Katër ekipe mjeksore komplet me pajisje	4 ekipe me nga 4 infermier, gjithësejt 16 infermier	
	Shtertër në emergjencë	4	
	Defibrilator	4	
	EKG-	3	
	Rentgen	2	
	Mamograf	1	
	Pajisje për Intubim	3	
	Shofer Emergjent -Infermier	15	
	Qanta me pajisje për reagim emergjent	4	
	Automjet për barje të bocave me oksigjen (4 boca)	1	

Ekipa Mjeksore Emergjente përbëhet nga 4 infermier dhe janë të pajisur me Automjet autoambulancë të ndihmës se shpejt e pajisur me të gjitha pajisjet e nevojshme, për intervenime në aksidente në komunikacion rrugor, apo kur ka të lënduar apo të infektuar nga tymi në rastet e zjarreve dhe rasteve të tjera sipas nevojës.

Sipas nevojës së e incidentit, nese komandanti I incidentit apo komandanti I njësis në vendin e ngjarjes, e sheh të nevojshme edhe ekipe të tjera , si Kryqi Kuq, OJQ, etj, atëher ato kyqen në intervenim, prandaj edhe duhet të jenë të pajisur me pajisje elementare për ndihmë.

Pajisjet themelore që Kryqi i Kuq i ka në disponim për intervenime emergjente(sipas të dhënave të tyre), janë paraqitur në tabelën në vijim.


Automjetet dhe pajisjet e Ekipës Emergjente në kuadër të Kryqit të Kuq	Sasia
Veturë xhip Land Cruiser 4x4 me të cilin mund të bartën deri 12 persona.	1
Instrukturë të licencuar për Ndhmën e Parë.	4
Vullnetarë të trajnuar për Përkrahje Psikosociale	3
Vullnetarë të trajnuar për Reagim në Fatkeqësi dhe Menaxhim Kampi .	2
Lese për bartjen e të lënduarve,	1
Qanta shpinore për ndihmë të parë	4
Pajisje për pune	3
Shofer Emergjent -	1
Vullnetar aktivë dhe të trajnuar në fusha të ndryshme si : Ndhmë të Parë, Përkrahje Psikosociale, Menaxhim të Kampit, Reagim në Fatkeqësi, etj	15 përsona

Komunikimi dhe ndërlihdjet.

Komunikimi për rreth vendit të ngjarjes bëhet në forma të ndryshme si ajo : Gojore, me telefona celular, radio lidhje etj.

Çdo ekip që gjindet në tëren për intervenim ,duhet të ketë nga një radiolidhje, apo telefon për komunikim intern me postin komandues, përkatësisht me Komandantin e Incidenit në vendngjarje.

Struktura e organizative e aktivizimit të Planit të Reagimit Emergjent apo QOEL, për zjarre, Aksidente rrugore, por edhe në rastet e tjera,duhet të jetë:



Nga skema shihet se pas marrjes se informatës nga zyra e alarmimit **(112)**, nga Policia apo edhe përsona të tjerë, për lokacionin e ngjarjës, menjëher njoftohet NJPSHZSH, dhe varësisht nga lloji ngjarjës (Zjarre fushoro-malore, zjarre në objekte banimi, objekte industriale, pompa të derivateve apo intervenime në aksidente të komunikacionit rrugor etj) , ekipa e zjarrfikësve përgaditë pajisjet e nevojshme për secilin lloj të intervenimit, dhe del në teren për intervenim.

Varësisht nga intenziteti i zjarrit, llojit, lokacionit, aktivizohen edhe ekipet e tjera emergjente. Nëse intenziteti i zjarrit është me përmasa të mëdha, atëherë mundë të aktivizohet edhe Qendra Operative Emergjente përmes Shtabit/Komitetit për Mbrojtje dhe Shpëtim, me të gjitha strukturat e saj, duke përfshirë Koordinatorin e menaxhimit emergjent, Komandantin e incidentit dhe Funksionet mbeshtetëse

emergjente (FME-të) dhe ekipet e tjera sipas nevojës për tu përgjigjur situatave të krijuara, dhe nëse është e nevojshme kërkohet ndihma nga komunat fqinje apo edhe nga niveli qendror.

Aktivitetet apo masat që janë paraparë për parandalimin e zjarreve fshoro-malore, në objekte: Ndërtimi, Industriale, prodhuese dhe në Pompat e derivateve të naftës janë të përmbledhura si në vijim:

- ❖ Hartimin dhe aprovimin e planeve reaguese emergjente lokale (PREL);
- ❖ Krijimin e procedurave standarde operative për reagim emergjent;
- ❖ Vendosjen e standardeve, udhëzimeve dhe protokolleve të nevojshme për koordinim dhe reagim emergjent të Shërbimeve reaguese emergjente dhe të akterëve tjerë të sigurisë;
- ❖ Ngritja (rritja) e kapaciteteve humane për reagim emergjent, përgatitja profesionale dhe certifikimi;
- ❖ Ngritja e kapaciteteve (resurseve) teknike dhe standardizimi i tyre;
- ❖ Të ngritet infrastruktura rrugore (me qëllim të reagimit më të lehtë me mjete motorrike) në pyje dhe të të sigurohen burimet ujore, sa më afër vatrave potenciale të zjarreve për furnizim;
- ❖ Të bëhet sanimi dhe gjenerimi i sipërfaqeve pyjore, pas zjarreve të shkaktuara;
- ❖ Të krijohet baza e të dhënave elektronike, për pasojat nga zjarret.;
- ❖ Arritja e memorandumeve të mirëkuptimit ndërkomunal me qëllim të ofrimit të ndihmës reciproke dhe bashkëpunimit me komunat fqinje, sektorin privat dhe OJQ humanitare, në rast se paraqitet nevoja;
- ❖ Kontrollimi i aparateve për mbushje të derivateve;
- ❖ Përseritja e atesteve të matjeve të rezistencës të tokëzimit dhe rrufepritësit;
- ❖ Ngritjen e Njësisë së mbrendëshme të Zjarrfikësve nga vet pronaret e objekteve prodhuese siq parashihet me ligj, dhe trajnimi i tyre;
- ❖ Rimbushja dhe servisimi i aparateve për shuarjen e zjarrit qdo 6 muaj;
- ❖ Instalimi i hidranteve në Objektet e prodhuese;
- ❖ Lajmëruesit automatik të zjarrit/lajmërimi dhe alarmimit automatik;
- ❖ Atestimi i këtyre sistemeve;
- ❖ Pajisja me mjete punë për zjarrfikësit për intervenime në zjarre në objekte banimi (automjet me Shkallë levizëse-hidraulike në lartësi deri 20 m), Dyshek, që shërbejn për kërcim nga lartësia)
- ❖ Atestet e matjeve të valvulave sigurorese të rezervuarve të Gasit;
- ❖ Pastrimi i rezervuarve të derivateve të naftes qdo 5 vite;

- ❖ Hartimi i raporteve të expertve të zjarrit, për sëcilin objekt të derivateve në naftes dhe Gazit;
- ❖ Pastrimin e borës nga rrugët , duke i prioritet rrugëve ku mund të paraqiten ortekët;
- ❖ Kriposjen dhe rërimit e rrugëve;
- ❖ Sinjalizimi me shenja të rrezikut në rrugët malore, ku reshjet e borës dhe krijimi i mundëshëm i ortekëve janë me të theksuara;

Siq po shihet këto masa parandaluese janë disa që duhet të realizohen nga Operatores Ekonomik dhe duke bër inspektime të rregullta nga Inspektoret komunal të fushave të caktuara, që këto masa të realizohen, ndërsa të tjerat janë obligim i komunës.

Plani i Reagimit Emergjent për Vërshime, Breshër.


Qëllimi i hartimit të këtij Plani specifik është :

- **Parandalimi i dëmeve që shkatohen nga përmbytjet ;**
- **Mbrojtja e jetës se njerëzve, pronës dhe infrastrukturës ;**
- **Përcaktimi i veprimeve dhe përgjegjësi në rast të Vërshimeve,Breshërit ;**

Prandaj duke u bazuar në Planin e Vlerësimit e Rrezikut, që ka paraparë që Vërshimet, erërat , breshëri, paraqesin një rrezik për jetët e njerëzve dhe shkatërrimit të pasurisë, dhe dëmeve të tjera, ku sipas statistikave nga NJPSHZSH , nga viti 2014 -2025, kemi pasur shumë raste të të intervenimeve në Vërshime, po thuhet se qdo vit, ku vlen për të përmendur vërshimet në vitin 2016, 2018, 2021 dhe 2024, ku si rezultat i reshjeve të pa ndërprera të shiut, kanë shkaktuar daljen e lumit Drenica dhe Verbica nga shtrati i tyre, duke shkaktuar dëme të konsiderueshme në objekte banimi, infrastrukturë rrugore (dëmtime të urave dhe tombinave, rrugëve të rendit të katërt me zhavor), dëmtime të pronave dhe kulturave bujqësore, dhe të gjitha këto dëme janë vlerësuar nga komisionet komunale për vlerësimin e dëmeve.

Si rezultat i shpeshësisë së ndodhjes se vërshimeve, është e nevojshme edhe aktivizimi i Planit të Reagimit Emergjent në rastet e përmasave të mëdha. Ndërsa në rastet kur përmasat janë të vogla, atëherë nuk bëhet aktivizimi i PREL, por këto situata që menaxhohen vet në kuadër të DSHPE-së, me funksionet mbështetëse FME#7.

Në rast të aktivizimit të PREL dhe QOREL, atëherë, struktura e organizimit duket si në vijim:



Nga skema Organizative, shihet se pas marrjes së informatës nga zyra e alarmimit (112), nga Policia apo edhe nga personat e tjerë të rrezikuar seriozisht nga vërshimet, menjëher aktivizohet PREL, ku fillimisht caktohet komandanti i Incidentit (KI) i cili fillimisht urdhëron ekipin e Zjarrfikësve, që të intervenoj me pajisjet adekuate, pastaj KI, urdhëron **Ekipin për evakuim dhe strehim** që të bëjë evakuimin e banorve (sipas nevojës) nga zona e rrezikuar dhe strehimin e tyre në strehimoret e caktuara sipas PVRR, dhe **Ekipin për logjistikë**, që të bëjë furnizimin me ushqim të të strehuarve në strehimore, pastaj mund të vazhdoj edhe evakuimi i kafsheve dhe shpezëve. Pas evakuimit fillon faza e reagimit për largimin e ujrave nga zonat e rrezikuara, ku aktivizohet edhe Operatori ekonomik për reagim emergjent, për të bërë hapjen e kanaleve

kulluese për dëptim të ujit, apo në disa vende edhe vendosjen e barrierave të përkohëshme për ndalimin e ujërave, dhe pastaj zjarrfikësit fillojnë largimin e ujrave nga shtëpitë të cilat pësuar nga vërshimet, përmes pompave të ujit.

Nese përmasat e vërshimeve janë më përmasa të mëdha dhe nuk mundë të menaxhohen nga niveli lokal, atëherë aktivizohet PREL dhe QOREL dhe Shtabi/Komiteti/ për Mbrojtje dhe Shpëtim, i cili kërkon ndihmë nga Niveli qendror përmesë AME-së, ku AME-ja, përmesë Ministrive relevante, mund të kyqen edhe njësitet e FSK-së, të specializuara për intervenime në vërshime, të cilët janë të pajisur me barka për shpëtim dhe pajisje të tjera të nevojshme.

Zyrtari për Informim i cili merr informata nga Komandanti i Incidentit, bënë informimin e rregullt për popullatën dhe hapat që duhet të ndjekur në rast të kësaj fatëkeqësie.

Në këtë rast mund të aktivizohen edhe ekipet emergjente, të cilat i parasheh Koordinatori i menaxhimit emergjent, dhe komandanti i Incidentit, duke aktivizuar ekipet mjeksore, për të dhënë ndihmë personave që janë shpëtuar dhe evakuuar nga ekipet për evakuim dhe strehim të FSK-së.

Pas stabilizimit të situatës, atëherë fillon edhe furnizimi me gjëra ushqimore, pasaj edhe me gjëra të tjera për shtroj dhe mbulojë.

Pas kësaj, fillon faza e rimëkëmbjes, duke filluar pastrimin e rrugëve të demtura, rehabilitim të përkohëshëm të tyre, rehabilitim të urave, tombinave, për të filluar zhvillimi i jetës normale.

Kur të përfundon situata, atëherë kryetari aktivizon edhe komisionet për vlerësimin e dëmeve të shaktuara nga vërshimet, dhe pas hartimit të raporteve të vlerësimit të dëmeve, kryetari i komunës dërgon kërkesën në Ministrinë relevante, për kompensim të dëmeve të shaktuara nga vërshimet.

Mbyllja e **QOREL**, ndodhë kur bëhet stabilizimi i plotë i situatës dhe fillon zhvillimi i jetës normale.

Për të zvogluar apo minimizuar shpeshtësinë dhe ashpërsinë e rasteve të vërshimeve që ndodhin për shkak të reshjeve të pandërpera të shiut, apo edhe të breshërit, Komuna ka planifikuar edhe aktivitetet dhe masat parandaluese për këto ngjarje të cilat po i paraqesim si me poshtë.

Aktivitetet dhe Masat parandaluese që duhet të mirren nga vërshimet:

- Rritja e kontrollit mbi ndërtimet e egra të objekteve të banimit afër shtretërve dhe brigjeve të lumi Drenica dhe Vërbica;
- Rregullimi i shtretërve të lumenjve sipas standardeve të kërkuara;
- Mirëmbajtja e rrjetit të ujërave atmosferike dhe fekale, kanaleve të hapura, shtretërve të lumenjve, urave, etj;
- Ndalimi i hudhjes së mbeturinave të amëvisërisë dhe atyre inerteve të ndryshme në lumenj, kanale dhe bllokimi i hapjeve të urave;
- Ndalimi dhe kontrolli i gjurmëve dhe eksploatimeve të pa kontrolluara të resurseve natyrore, meqë rast ndërron edhe kaha e rrjedhës së ujit e më pastaj dalja nga shtrati;
- Mirëmbajtja e shtretërve të lumenjeve nga organet kompetente;
- Zgjerimi i shtretërve të lumenjve nga pronarët që i posedojnë ngastrat pranë;
- Hapja e kanaleve anësore (të kullimit) të rrugëve.
- Ndërtimi i **tombinave dhe urave**, në rrugët ku ka fyte të ngushta të shtratit të lumit Drenica dhe Verbica dhe prrockave të tyre.

Masat parandaluese nga breshëri:

- Informimi dhe paralajmërimi me kohë, duke bërë instalimin e sistemeve të paralajmërimit të hershëm, përmes aplikacioneve të motit, radarve dhe alarme lokale (MMPH);
- Fushata vetëdijësuese për fermerë;
- Vendosja e sistemit mbrojtës për shpërndarje të reje të breshërit, (nga MMPH);
- Vendosja e sistemit të mbrojtjes së pemëve me rrejtë plastike, kopshte dhe plantacione të pemëve, vreshtave, ose kultura të tjera nga vetë fermerët,
- Sigurimi i të mbjellave nga dëmtimet klimatike (breshërit) përmes skemave të sigurimit bujqësor nga fermerët.

Plani i reagimit emergjent për Epidemitë, Endemitë dhe Pandemitë

Qëllimi i hartimit të këtij Plani është :

- **Parandalimi i përhapjesë se këtyre Epidemive dhe Pandemisë që shkatohen nga viruset e ndyshëm;**
- **Mbrojtja e jetës se njerëzve;**
- **Përcaktimi i veprimeve dhe përgjegjësi në rast të Epidemive dhe Pandemive;**

Për këtë qëllim duke u bazuar në Planin e Vlerësimit të Rrezikut , ku ka vlerësuar edhe rrezikun nga Epidemitë, Endemitë dhe Pandemitë, atëherë është i nevojshem edhe hartimi i planit të reagimit emergjent edhe për këto lloje të rreziqeve.

Në tërësi jo vetëm komuna e Gllogocit, por edhe i tërë territori i Kosovës kanë qenë të përfshirë nga infeksioni nga virusi COVID-19 , SARS I DHE SARS II, e cila u shpall nga OBSH si Pandemi.

Përpos Pandemisë në komunën tonë janë prezent edhe Epidemitë, si gripet sezonale, infeksionet e ndryshme, por janë të menaxhueshme nga institucionet shëndetësore të nivelit parësor, ku sipas statistikave të marrura nga DSHMS dhe QKMF-ja, në Drenas, kemi këto të dhëna:

Gjatë fazës së Pandemisë në komunën e Gllogocit janë prekur gjithësejt **3420 raste, prej tyre janë shëruar 3334 raste, ndërsa 89 raste** kanë përfunduar me mortalitet.


Kurse nga Epidemitë ka pasur edhe sëmundje ngjitëse, infektive, ky këty hynë edhe viruset sezonal, që më të shprehur kanë qenë të diagnostifikuar me diagnozën **Diahorea et gastroenterisits (A09)**, me gjithësejt **2393 raste, sëmundje infektive (A02-04-05-07-09), 291 raste** , pastaj **variola herpes zoster (B01-02)**, me **253 raste**, dhe sëmundje të tjera, gjatë vitit 2023, ndërsa gjatë vitit 2024 janë regjistruar ky numer i këtyre sëmundjeve, me diagnozën **Diahorea et gastroenterisits (A09)**, me gjithësejt **262 raste, sëmundje infektive(A02-04-05-07-09), 10 raste** , pastaj **variola herpes zoster (B01-02)**, me **34 raste**.

Nga këto statistika të marruara nga raporti i **QKMF-së** po shihet se rastet me Epidemi në vitin 2024 kanë rënë ndiheshem , krahasuar me vitin 2023.

Bartës kryesor dhe përgjegjes për nivelin parësor shëndetësor është Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale, që është në përgjegjësi të Komunës, si dhe Qendra kryesore e Mjekësis Familjare, QKM-të, dhe AMF-të.

Për Pandemi kanë qenë të caktuara masat parandaluese të caktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, të cilat masa janë zbatuar edhe nga nivelet lokale.

Në rastin e Pandemisë, komuna e Gllogocit ka ngritur dhe aktivizuar Planin e Reagimit Emergjent/Qendrën operative emergjente lokale/ se bashku me të gjitha strukturat e sa (**Qendrat Operative të Shtabeve lokale**), të cilat janë aktivizuar gjatë kohës së Pandemisë, që po e paraqesim si në diagramin e më poshtëm:



Siq poshihet nga skema , rolin kryesor në nivel lokal/komunal/ në këtë ngjarje e ka Shtabi/Komiteti për Mbrojtje dhe Shpëtim, **IKSHPK** (Instituti Kombëtar i Shëndetësisë publike të Kosovës), Drejtorati për Shëndetësi

dhe Mirëqenje Sociale, në bashkëpunim me Drejtorin për Shërbime Publike dhe Emergjencë, ndërsa rolin **Operativ kryesor** e ka

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare dhe ekipet mjeksore emergjente, **Qendren për vaksionim, Qendrat Operative të Shtabeve Lokale, Ekipet logjistike, kryqi i kuq etj.** Gjatë Pandemisë e cila ishte me përmasa të mëdha, angazhimin kryesor në organizimin dhe menaxhimit e virusit COVID-19, e kishte IKSH, Qendrat Spitalore në kuadër të QKUK-s-së, se bashku me komunat dhe DSHMS-ja, me strukturat e saj.

Ndërsa tek rastet e Epidemive, sëmundjeve infektive lokale me gripeve sezonale, rolin kryesor e ka **DSHMS-ja, me Qendren e Mjekësisë Familjare, QKM-të dhe AMF-të**

Masat parandaluese në rastet e Pandemisë janë:

- Fushata të Informimit rreth simptomave të virusit dhe mënyrat e mbrojtjes,
- Qëndrimi në shtëpi në rast të simptomave,
- Vaksionimi,
- Kufizimet e tubimeve publike, (mbajtja e distancës, vendosja e maskave, larja e duarve etj)
- Rritja e kapaciteteve spitalore të QKMF-ve, QKM-ve, AMF-ve, si në aspektin teknik ashtu edhe në atë profesional.
- Testimet për diganostifikim të virusit.

Masat parandaluese nga Epidemitë, janë veprime dhe strategji që ndërmerren për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve infektive në komunën e Gllogocit, të cilat janë:

- Masa Hixheno-sanitare;
- Izolimi dhe karantinimi i rasteve të gripit sezonal;
- Vaksionim kunder gripit sezonal;
- Kontrolli i burimeve të infeksionit (kontrolli i insekteve që transmetojn sëmundje: si mushkonjat për Malarien, virusve të ndryshëm etj);
- Sigurimi i ujit të pastërt,
- Përgaditja dhe reagimi i Institucioneve (sigurimi i furnizimeve mjeksore, ilaqe, pajisje të tjera mjeksore);

PËRFUNDIM

Plani i Reagimit Emergjent komunal përfaqëson një instrument thelbësor për garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes së qytetarve në rast të emergjencave natyrore apo të shkatuara nga njeriu. Ky plan është hartuar duke u bazuar në vlerësimin e rreziqeve të mundshme në teritorin e komunës, kapacitetet ekzistuese të reagimit, si dhe mekanizmat e bashkëpunimit ndërinstitucional.

Zbatimi i sukseshëm i këtij plani kërkon angazhimin aktiv të të gjitha strukturave komunale, shërbimeve emergjente, institucioneve publike dhe komunitetit.

Trajnimi i vazhdueshëm, komunikimi efektiv dhe koordinimi ndërmjet akterëve janë elemente kyq për të siguruar një përgjigje efikase dhe të shpejtë ndaj qdo situatë.

Përmes këtij Plani, komuna e demonstron përkushtimin për të mbrojtur jetën, shëndetin dhe pasurin e qytetarve, duke vendosur parimet e parandalimit, përgaditjes, reagimit dhe rimëkembjes në qendër të veprimeve të saj.

Ky dokument do të jetë objekt i rishikimeve periodike në përputhje me zhvillimet ligjore, ndryshimet në strukturën e rrezeve dhe përmirësimet në kapacitetet operationale të komunës